



RAPORTI VJETOR

2020

RAPORTI
VJETOR
2020

Përmbajtja

Mesazhi nga Bordi i Drejtorëve.....	6
Mesazhi nga menaxhmenti ekzekutiv	8
Struktura organizative e Bankës.....	14
Vizioni	15
Misioni	15
Vlerat tona	15
Mjedisi makroekonomik	17
Sektori bankar	20
Pozicionimi i Bankës Ekonomike në tregun Bankar të Kosovës.....	22
Pjesëmarrja në kredi.....	24
Pjesëmarrja në depozita	26
Pasqyra e pozicionit financiar	28
Performanca e Bankës Ekonomike	32
Asetet e Bankës.....	32
Ecuria e kredive	34
Ecuria e depozitave	35
Zhvillimi i biznesit.....	40
Gjithsej kreditë	42
Klientët korporatë	42
Klientët e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	44
Klientët individualë	46
Lizingu	47
Përgjegjësia shoqërore e korporatave	48
Mbështetja për shëndetësinë.....	48
Mbështetja për nxënësit e komunës së Prishtinës.....	49
Mbështetja për veprimtarit sociale.....	49
Mbështetja për SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë	49

Mbështetja për Asociacionin Nacional të Autizmit në Kosovë.....	50
Mbështetja për fëmijët me sindromë Down	50
Mbështetja për shoqatën Handikos	50
Mbështetja për sportin	51
Mbështetja për kulturë.....	52
Kanalet e distribuimit.....	53
Rrjeti i degëve.....	53
Kanalet alternative të distribuimit	54
Menaxhimi i rrezikut.....	56
Menaxhimi i rrezikut kreditor	57
Rreziku operacional.....	60
Rreziku i likuditetit dhe tregut.....	61
Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit.....	62
Komiteti për menaxhim të rrezikut (KMR).....	62
Operacionet dhe pagesat	63
Transferet kombëtare	64
Transferet ndërkombëtare	65
Kartelat bankare	66
Siguria e informacionit dhe teknologjia informative	67
Menaxhimi dhe trajnimi i personelit	68
Besimi te punonjësit	70
Pajtueshmëria e përgjithshme.....	72

Monedhat e mbretit Monunius - 280 para erës së re



MESAZHI NGA BORDI I DREJTORËVE

Të nderuar klientë, aksionarë dhe punonjës,

Ne shpresojmë se do vazhdojmë me tejkalim të situatës me COVID-19 dhe në vijimësi të punojmë në mjedis dhe kushte normale të aktivitetit, duke fokusuar të gjitha përpjekjet tona për të përmirësuar cilësinë dhe shërbimet bankare gjatë vitit 2021.

Por, para së gjithash, synimi ynë në vitin 2021 është të kujdesemi ndaj punonjësve dhe klientëve tanë për t'i mbrojtur nga Covid-19, si dhe duke mundësuar ofrim të shërbimeve bankare pa asnjë ndërprerje.

Në aspektin e rezultateve dhe indikatorëve financiarë, Bordi Drejtues ka kënaqësinë të prezantojë rezultatet pozitive të arritura nga Banka Ekonomike për vitin 2020, pavarësisht rënies ekonomike në vend për shkak të pandemisë. Rezultatet e arritura tregojnë rritjen e performancës së Bankës dhe aftësinë e punonjësve tanë për të zbatuar strategjinë me efikasitet në një treg shumë konkurrues dhe sfidues.

Gjatë vitit 2020, Bordi Drejtues ka mbajtur takimet e rregullta dhe ato të jashtëzakonshme sipas nevojës, në mënyrë që të përcjellin mbikëqyrjen e politikave dhe zbatimin e strategjisë së Bankës. Gjithashtu, në takimet e Bordit Drejtues është diskutuar dhe vendosur për tema të tjera që lidhen me menaxhimin në përgjithësi, kulturën korporative në Bankë, koordinimin dhe kontrollin, implementimin e rregulloreve të BQK-së të nxjerra/lëshuara gjatë pandemisë, sistemet e pajtueshmërisë dhe kompensimit. Neve si Bord Drejtues na është raportuar në baza të rregullta për zhvillimin e biznesit, zhvillimin financiar, pasqyrat financiare, rrezikun e Bankës, likuiditetin dhe administrimin e kapitalit, burimet e duhura teknike dhe organizative si dhe çështjet e tjera me rëndësi për Bankën. Si Bord Drejtues, në bashkëpunim me Ekzekutivin dhe Menaxhmentin e Lartë, kemi miratuar politika dhe vendime me rëndësi thelbësore për Bankën.

Në takimet e Bordit Drejtues i është dhënë hapësira e duhur Departamentit të Pajtueshmërisë së Përgjithshme si funksion raportues direkt tek Bordi Drejtues, me qëllim të adresimit të kërkesave të reja rregullative, trajtimit të rasteve për parandalim të mashtrimeve dhe zbatimit të kodit të mirësjelljes. Gjithashtu, si funksion tjetër raportues direkt tek Bordi Drejtues, vëmendje e veçantë i është dhënë edhe Departamentit të Pajtueshmërisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave, ku është diskutuar për statusin dhe zhvillimet në këtë departament, si dhe automatizimin e proceseve dhe pjesën e menaxhimit të procesit “KYC – know your client”.

Komiteti i Auditimit, si komitet i veçantë, ka raportuar në baza të rregullta në mbledhjet e Bordit Drejtues, duke adresuar çështje të ndryshme sipas raporteve të auditimeve që janë bërë në periudhat e raportimit. Këto raporte janë trajtuar me seriozitetin më të lartë me qëllim që proceset e Bankës të përmirësohen në vazhdimësi.

Komiteti i Menaxhimit të Riskut ka mbajtur takime të rregullta me agjenda përkatëse sipas rregulloreve në fuqi. Zyrtares Kryesore të Riskut ka raportuar dhe ka përpiluar strategjitë dhe politikat e menaxhimit të riskut të Bankës dhe të njëjtat, në këshillim me Komitetin për Menaxhimin e Riskut, janë shqyrtuar dhe aprovuar në takimet e Bordit Drejtues.

Bordi Drejtues falënderon të gjithë punonjësit e Bankës Ekonomike për përkushtimin dhe arritjen e objektivave të caktuara për vitin 2020. Një falënderim i posaçëm u drejtohet klientëve dhe aksionarëve tanë për mbështetjen dhe besimin e dhënë.

**Në emër të Bordit Drejtues,
Lirim Shulina
Kryesues**

MESAZHI NGA MENAXHMENTI EKZEKUTIV

Të nderuar kolegë, klientë, bashkëpunëtor dhe aksionar të Bankës Ekonomike,

Kemi kënaqësinë e veçantë t'ju drejtohem në emër të Menaxhmentit Ekzekutiv, për të ndarë me ju të arriturat dhe sfidat tona të përbashkëta gjatë vitit 2020.

Viti 2020 nuk ishte një vit i zakonshëm. Pandemia Covid-19 ka sfiduar gjithë botën dhe rrjedhimisht ka ndikuar edhe në vendin dhe institucionin tonë, duke e bërë operimin dhe arritjen e objektivave sipas planifikimeve shumë më sfidues. Sfidat të cilat i krijoj pandemia kërkuan një qasje të shpejtë, të kujdesshme dhe profesionale për t'i adresuar ato, ndërsa falë edhe angazhimit të jashtëzakonshëm të gjithë punonjësve tanë, kemi arritur të vazhdojmë ofrimin e shërbimeve pa ndërprerë për klientët tanë, natyrisht duke ndërmarr masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit tanë të ekspozuar ndaj rrezikut të infektimit me Covid-19, dhe me kujdes të veçantë kemi zbatuar të gjitha rekomandimet e institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e pandemisë dhe ruajtjen e shëndetit publik.

Banka jonë u shpreh mirënjohjen dhe falënderon të gjitha institucionet publike të cilat ishin drejtpërdrejtë përgjegjëse për ruajtjen e shëndetit publik dhe luftimin e pandemisë, si dhe ka një falënderim të veçantë për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës për mbështetjen dhe masat e ndërmarra gjatë kësaj periudhe.

Mjedisi makro-ekonomik në Kosovë ka pasur një ngadalësim dhe trend të rënies si pasojë e përballjes me pandeminë Covid-19 dhe masave të ndërmarra nga institucionet për mbyllje dhe kufizim të aktivitetit ekonomik. Masat kufizuese të ndërmarra kanë rezultuar me një rënie mesatare prej 5.6 përqind të aktivitetit ekonomik në nëntë muajt e parë të vitit 2020. Në kuadër të BPV-së, komponentët e investimeve dhe eksporteve neto janë zvogëluar me 6.5, përkatësisht 6.4 pikë përqindje. Në anën tjetër, aktiviteti ekonomik u mbështet nga kontributi pozitiv i konsumit me 7.4 pikë përqindje.

Përkundër sfidave me pandeminë Covid-19, Banka jonë ka vazhduar të tregojë qëndrueshmëri dhe të jap rezultate pozitive financiare dhe operacionale. Në një treg shumë konkurrues dhe njëkohësisht sfidues, Banka ka vazhduar zbatimin e strategjisë me efikasitet, duke vazhduar kreditimin e pa ndërprerë të klientëve si dhe modernizimin e mëtejshëm të produkteve dhe shërbimeve sipas nevojave dhe kërkesave të klientëve tanë dhe zhvillimit të tregut.

Fitimi para tatimit i Bankës Ekonomike për vitin 2020 është 4.48 milionë euro. Përkundër një ambienti të tillë tejet sfidues, këto rezultate u bënë të mundura falë besimit të klientëve në produktet dhe shërbimet tona dhe angazhimit të punonjësve tanë për zbatim efikas të strategjisë së bankës. Gjatë këtij viti, me një qasje të matur dhe të kujdesshme, kemi rritur portfolion kreditorë për 41,4 milionë euro (↑19.20 përqind), ndërsa portfolio jonë vazhdon të jetë cilësore në nivel të kredive joperformuese me vetëm 2.46 përqind. Besimi i klientëve në Bankën Ekonomike vazhdon të rritet nga viti në vit, e kjo dëshmohet më së miri përmes depozitave, të cilat arritën nivelin më të lartë ndonjëherë, në 330.3 milionë euro (↑16.84 përqind). Pasuritë/asetet e përgjithshme të Bankës Ekonomike u rritën në 367.9 milionë euro, krahasuar me 322.5 milionë euro sa ishin në fund të vitit 2019.

Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimit për klientë vazhdoi të jetë një prioritet i rëndësishëm edhe në vitin 2020, dhe ne si gjithmonë jemi fokusuar në përmirësimin e kënaqshmërisë së klientëve me të gjitha produktet dhe shërbimet tona dhe në të njëjtën kohë kemi vazhduar me modernizimin e rrjetit të degëve duke rialokuar dhe rinovuar disa nga degët tona, me qëllim të ofrimit të një ambienti sa më të përshtatshëm dhe të qasshëm për të gjithë klientët dhe punonjësit tanë. Ne besojmë se degët dhe prezenca fizike luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin e shërbimit sa më cilësor për klientët.

Gjithashtu, kemi vazhduar të investojmë në trajnimin e punonjësve dhe zhvillimet teknologjike si pjesë e zotimit tonë që të tejkalojmë vazhdimisht pritshmërinë e klientëve tanë dhe të rrisim efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve.

Krahas operimit në sistemin financiarë, gjatë vitit 2020 rëndësi të veçantë i kemi kushtuar edhe investimeve në fushën e Teknologjisë Informative dhe Sigurisë së Informacionit me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë. Gjithashtu në linjë me strategjinë tonë, rëndësi të veçantë i kemi kushtuar edhe aktiviteteve të përgjegjësive shoqërore të korporatave, meqë rast këtë vit kemi mbështetur punonjësit shëndetësor dhe institucionet e ndryshme në luftën kundër pandemisë Covid-19, si dhe kemi vazhduar mbështetjen në fushat e arsimit, kulturës, sportit dhe mirëqenies sociale.

Në fund, në emër të Menaxhmentit Ekzekutiv dëshirojmë të falënderojmë të gjithë punonjësit e Bankës Ekonomike për përkushtimin dhe arritjen e objektivave të caktuara për vitin 2020 përkundër rrethanave me të cilat u ballafaquam si shoqëri. Një falënderim i veçantë i drejtohet klientëve dhe aksionareve tanë për mbështetjen dhe besimin e dhënë.

Shpresojmë që në vitin 2021 të lëmë prapa pandeminë dhe t'i kthehemi normalitetit të plotë!

Menaxhmenti Ekzekutiv i Bankës Ekonomike



Shpend Luzha
U. D. Kryeshef Ekzekutiv



Hamide Pacolli Gashi
Zv. Kryeshefe Ekzekutive



Arijan Haxhibeqiri
Zv. Kryeshef Ekzekutiv




Banka Ekonomika

PRISHTINA
PRISHTINA
BAPTISTE
NORA GRILL


Banka Ekonomika
Cindria

PRISHTINA


Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit




Asetet (në milionë EUR)




Kreditë (në milionë EUR)




Depozitat
(në milionë EUR)




Kreditë joperformuese
(KJP)



Fitimi para tatimit
(në milionë EUR)





VIZIONI

- Bankë e orientuar në rritje të qëndrueshme dhe kualitative, shërbime cilësore dhe standarde të larta profesionale.

MISIONI

- Profilizimi si bankë e klientëve individual dhe NVM nëpërmjet modelit të biznesit, gamës së produkteve dhe shërbimeve si dhe strategjisë së marketingut;
- Ofrimin e shërbimeve me dizajn specifik për klientin nëpërmjet koncepteve si VIP, Lizing dhe Agro Biznes;
- Bankë për zhvillim profesional të stafit nëpërmjet programeve të trajnimit, planifikimit dhe orientimit të karrierës;
- Ofrim të shërbimeve 24/7 nëpërmjet kanaleve alternative në një mjedis dhe dizajn të sofistikuar;
- Digjitalizimi i shërbimeve financiare dhe proceseve nëpërmjet avancimit teknologjik.

VLERAT TONA

Ne karakterizohemi nga PUNA EKIPORE, përmes së cilës i përmbushim nevojat e klientëve tanë. Puna ekipore sjell respekt të ndërsjellë, marrëdhënie më të mira ndër-njerëzore dhe fuqizim drejt arritjes së objektivave tona të përbashkëta.

Ne karakterizohemi nga RESPEKTI për njëri-tjetrin dhe RESPEKTI për klientët.

Ne karakterizohemi dhe jemi të angazhuar për standarde të larta ETIKE dhe profesionale, duke demonstruar sjellje të ndershme, profesionale dhe etike në marrëdhëniet tona me kolegët, klientët dhe shoqërinë.



Monedhë epirote të kohës së mbretit Pirro

MJEDISI MAKROEKONOMIK

Situata me pandeminë Covid-19 dhe përkeqësimi i krizës shëndetësore si pasojë e valës së re të shpërndarjes së virusit ndikoi që vendet e eurozonës të ndërmarrin sërish masa për kufizimin e lëvizjes dhe aktiviteteve, gjë që rezultojë në tkurrje të aktivitetit ekonomik prej 5.0 përqind në TM4 2020.

Në mesin e vendeve kryesore të Eurozonës, Gjermania dhe Franca raportuan rënie të aktivitetit ekonomik, ku Gjermania pati rënie prej 3.9 përqind dhe Franca prej 5.0 përqind, përderisa Italia dhe Spanja shënuan rënie edhe më të lartë të aktivitetit ekonomik me 6.6 përqind dhe 9.1 përqind respektivisht.

Në anën tjetër, aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka vazhduar të rritet. Kjo rritje që është e evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 6.4 përqind gjatë TM4 2020, ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.5 përqind. Me rritje të lartë janë karakterizuar edhe depozitat, ku depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 20.7 përqind, ndërsa depozitat e ekonomive familjare u rritën për 8.7 përqind.

Edhe vendet e Ballkanit Perëndimor u goditën nga pandemia Covid-19, duke u futur në një recesion të thellë. Sipas të dhënave kombëtare, rënia më e lartë ekonomike është shënuar në TM2 2020 (mesatarisht 12.2 përqind), ndërsa në TM3 2020 aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizua me rënie mesatare prej 8.5 përqind.

Edhe Kosova shënoi rënie të konsiderueshme të aktivitetit ekonomik, kryesisht si pasojë e rënies së vizitave nga diaspora për shkak të kufizimeve në lëvizje të vendosura në vendet kryesore të eurozonës ku edhe janë më të koncentruar diaspora.

Masat kufizuese të ndërmarra kanë rezultuar në rënie mesatare të aktivitetit ekonomik prej 5.6 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2020. Në kuadër të BPV-së, komponentët e investimeve dhe eksporteve neto janë zvogëluar me 6.5, përkatësisht 6.4 pikë përqindje. Në anën tjetër, aktiviteti ekonomik u mbështet nga kontributi pozitiv i konsumit me 7.4 pikë përqindje.

Indeksi i çmimeve të konsumit shënoi rritje të ngadalësuar prej 0.2 përqind në vitin 2020 (2.7 përqind rritje në 2019). Duke filluar nga muaji korrik, është raportuar nga ASK për rënie të çmimeve, përderisa mesatarja e deflacionit në TM4 2020 ishte 0.1 përqind.

Borxhi publik në TM4 2020 ka arritur në 1.5 miliardë euro, që është për 23.9 përqind më i lartë krahasuar me TM4 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind, nga 17.5 përqind sa ishte në TM4 2019. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 21.5 përqind (që ka arritur në 961.9 milionë euro), si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik për 28.6 përqind (që ka arritur në 525.8 milionë euro).

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 236.8 milionë euro, kryesisht të ndikuara nga aktiviteti i sektorit bankar dhe sektorit të sigurimeve.

Sektori i jashtëm u karakterizua me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse në vitin 2020 për 7.5 përqind dhe ka arritur vlerën prej 429.4 milionë euro. Në raport me BPV-në, deficitin e llogarisë rrjedhëse arriti në 6.4 përqind nga 5.6 përqind në vitin 2019.

Burimi: *Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike*



SEKTORI BANKAR

Sektori bankar kishte kontributin kryesor në rritjen e asetëve të sistemit financiar, vlera e asetëve në fund të vitit 2020 ishte 5.35 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 12.4 përqind, (13.7 përqind në periudhën paraprake). Ndërsa sektori pensional, si sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, përbënë 25.3 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar.

Si rezultat i gjendjes pandemike, për herë të parë në pesë vitet e fundit, aktiviteti kreditues u karakterizua me ngadalësim të dinamikës së rritjes nga rritja dyshifrore në një-shifrore.

Vlera e gjithsej kredive aktive në fund të TM4 2020 arriti në 3.25 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.1 përqind (rritje prej 10.0 përqind në fund të TM4 2019).

Kreditë ndaj korporatave jofinanciare, me pjesëmarrje prej 63.3 përqind në gjithsej kreditë, ngadalësuan rritjen në 7.2 përqind nga 9.8 përqind në periudhën në fund të dhjetorit 2019. Ngjashëm, kreditë ndaj ekonomive familjare ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore në 7.1 përqind nga 10.4 përqind një vit më parë.

Totali i kredive është 3,246.4 milion euro, ku kreditë për ndërmarrjet përbëjnë 63.5 përqind ndërsa kreditë për individët 36.3 përqind. Shumica e këtyre kredive absorbohen nga sektori i ndërmarrjeve tregtare (46.3 përqind e kredive për ndërmarrjet), ndërsa kreditë e lëshuara për sektorin industrial (përfshirë minierat, prodhimin, energjinë dhe ndërtimin) përbëjnë 25.8 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet. Sektori i bujqësisë përfaqëson 2.7 përqind të gjithsej kredive.

Gjatë vitit 2020, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) mundësoi ristrukturimin e kredive si masë lehtësuese për klientët/kredimarrësit e prekur nga kriza e shkaktuar nga pandemia Covid-19. Si rrjedhojë, gjatë periudhës mars-dhjetor 2020, mesatarisht rreth 38.0 përqind e total stokut të kredive ishin kredi të riprogramuara kurse niveli i tyre historikisht kishte një mesatare prej 1.0 përqind. Gjithashtu, një proces tjetër në këtë drejtim ishte edhe shtyrja e kësteve kreditore duke hequr interesin ndëshkues dhe duke ruajtur historikun kreditor të klientëve.

Depozitat në sektorët bankarë kanë regjistruar një rritje vjetore prej 11.5 përqind, duke arritur në 4,358.8 miliardë euro. Depozitat në sektorin bankar përbëhen nga depozitat e familjeve, të cilat marrin pjesë me një pjesëmarrje prej 67.4 përqind në gjithsej depozitat, ndërsa depozitat e ndërmarrjeve të sektorit privat përbëjnë 25.0 përqind të gjithsej depozitave.

Kreditë joperformuese, megjithëse kanë shënuar rritje krahasuar me tremujorët paraprak, niveli i tyre ndaj gjithsej kredive vazhdon të jetë i ulët. Norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2020 qëndroi në nivel prej 2.7 përqind (2.0 përqind në fund të dhjetorit 2019).

Në sektorin bankar janë të punësuar gjithsej 3,391 punonjës.

Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar

POZICIONIMI I BANKËS EKONOMIKE NË TREGUN BANKAR TË KOSOVËS


Në vitin 2020, Banka jonë ka arritur të ruajë pozicionin e saj në treg, duke ndjekur trendin e tregut bankar, i cili vazhdon të shënojë rritje. Rritja e tregut bankar në të gjitha asetet prej 12.59 përqind është ndikuar edhe nga Banka jonë, e cila ka shënuar rritje në të gjitha asetet prej 14.08 përqind, përkatësisht 2 përqind më shumë se rritja e tregut.

Në numra realë, në fund të vitit 2020, pasuritë/asetet e përgjithshme të Bankës Ekonomike u rritën në 367.9 milionë euro krahasuar me 322.5 milionë euro sa ishin në fund të vitit 2019.

Figura 1. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në rritjen e përgjithshme të aseteve të tregut, 31 dhjetor 2020;



Figura 2. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në rritjen e përgjithshme të total aseteve të tregut, 31 dhjetor 2020;



PJESËMARRJA NË KREDI

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total kreditë në treg, më datën 31 dhjetor 2020, qëndronte në 7.94 përqind të sektorit të përgjithshëm bankar.

Gjatë vitit 2020, Banka jonë ka shënuar një rritje prej 19.20 përqind në kredi, në krahasim me tregun që ka shënuar një rritje prej 7.39 përqind.

Figura 3: Rritja e Bankës Ekonomike në kreditë e përgjithshme në raport me tregun, 31 dhjetor 2020;





Figura 4. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në volumet e kredive në raport me tregun, 31 dhjetor 2020;



PJESËMARRJA NË DEPOZITA

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total depozitat në treg, me datën 31 Dhjetor 2020, ka qenë 7.78 përqind të sektorit të përgjithshëm bankar në Kosovë.

Gjatë vitit 2020, Banka jonë ka shënuar një rritje prej 16.71 përqind në depozita, në krahasim me tregun që ka shënuar një rritje prej 11.30 përqind.

Figura 5. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në depozita në raport me tregun, 31 dhjetor 2020;





Figura 6. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në volumet e depozitave në raport me tregun, 31 dhjetor 2020;



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Bilanci i gjendjes me: 31.12. 2020	Euro '000
	31/12/2020
Pasuritë	
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	69,657
Kërkesat ndaj bankave	12,733
Investimet në letra me vlerë	25,365
Neto kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	247,123
Patundshmëritë dhe pajisjet	8,767
Pasuritë e paprekshme	2,813
Pasuritë tatimore, të shtyra	
Pasuritë tjera	1,423
Gjithsej pasuritë	367,882
Detyrimet	
Depozitat e klientëve	330,281
Detyrimet ndaj bankave	2,080
Fondet tjera të huazuara	0
Detyrimet tatimore, të shtyra	6
Detyrimet tjera	2,184
Gjithsej detyrimet	334,550

Ekuiteti i aksionarëve	
Kapitali aksionar	29,422
Rezervat e kapitalit	-99
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	0
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	4,009
Përbërësit tjerë të ekuitetit	0
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	33,332
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve	367,882



Monedhë epirote të kohës së mbretit Pirro

Pasqyra e të ardhurave me: 31.12. 2020	Euro'000
	31/12/2020
Të hyrat nga interesi	17,966
Shpenzimet e interesit	(2,640)
Neto të hyrat nga interesi	15,326
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	2,774
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	(1,478)
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	1,296
Neto të hyrat nga tregtimi	165
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	49
Shpenzimet e personelit	(3,466)
Shpenzimet tjera administrative dhe operative	(4,463)
Shpenzimet e zhvlerësimit/amortizimit	(2,277)
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	983
Gjithsej të hyrat	7,612
Provizionet për humbjet nga kreditë	(3,133)
Fitimi/(humbja) para tatimit	4,479
Shpenzimet e tatimit në fitim	(470)
Fitimi/(humbja) neto	4,009
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	(309)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	3,700



PERFORMANCA E BANKËS EKONOMIKE

Duke vazhduar traditën e rritjes dhe ruajtjes së kënaqshmërisë së klientëve, si dhe duke punuar vazhdimisht për arritjen e objektivave të performancës financiare, Banka jonë edhe në vitin 2020, ka shënuar progres në shumicën e treguesve financiarë, duke e mbyllur vitin me fitim para tatimit me 4.48 milionë euro.

Të hyrat neto nga interesi kanë pasur rritje në krahasim me vitin e kaluar për 13.4 përqind, ndërsa të hyrat neto nga komisionet kanë shënuar rënie prej 6.1 përqind.

Banka jonë mbetet e përkushtuar që të realizojë planet e saj afatgjate strategjike, në mënyrë që të vazhdojë të kryejë operacionet me sukses gjithmonë në ngritje.

Asetet e Bankës

Përkushtimi ndaj vlerave, objektivave të performancës dhe angazhimi i vazhdueshëm drejt zgjerimit të rrjetit dhe infrastrukturës së bankës ka rezultuar në rritje të aseteve të bankës për të pestin vit me radhë. Këtë vit, rol të rëndësishëm në rezultatin e rritjes së aseteve ka pasur edhe rritja e portfolios kreditore. Banka jonë ka mbyllur vitin 2020 me 368 milionë euro për dallim nga 2019 kur kishte 323 milionë euro asete.

Figura 7. Asetet e Bankës Ekonomike, 2016-2020;




Të gjithë shifrat janë në '000 Euro.

Ecuria e kredive

Menaxhimi i duhur i portfolios dhe menaxhimi i balancuar i rrezikut kanë ndikuar që edhe këtë vit të vazhdojë trendi i rritjes dhe Banka jonë të ketë rritje të dukshme në portfolion e kredive, përfshirë sektorin privat dhe atë të biznesit. Gjatë vitit 2020 portfolio e kredive është rritur nga 216 milionë euro në 257 milionë euro.

Figura 8. Portfolio e kredive, 2016-2020;



Të gjithë shifrat janë në '000 Euro.


Banka Ekonomike ka promovuar në mënyrë të vazhdueshme produktet e saj më të mira të kredidhënies me fushata marketingu.

Ecuria e depozitave

Rritja e vazhdueshme e depozitave është një tregues më shumë për rritjen e vazhdueshme të besimit të klientëve ndaj shërbimeve të Bankës Ekonomike. Viti 2020 ka shënuar rritje të depozitave në 330 milionë euro nga 285 milionë euro sa ishte në vitin paraprak.

Figura 9. Depozitat e klientëve, 2016-2020;


Depozitat e klientëve - Banka Ekonomike



Të gjithë shifrat janë në '000 Euro.

	Euro '000	2016	2017	2018	2019	2020
Të hyrat nga interesi		13,450	13,835	14,500	15,841	17,965
Kostot e depozitave		2,273	2,192	2,316	2,415	2,729
Të hyrat NETO nga interesi		11,177	11,643	12,184	13,426	15,236
Neto të hyrat nga komisionet dhe tarifatat		1,673	1,876	1,931	2,162	2,030

Figura 10. Të hyrat neto nga interesi, 2016-2020;



Të gjithë shifrat janë në '000 Euro.

Shpenzimet operative

Euro '000	2016	2017	2018	2019	2020
Shpenzimet administrative	4,081	4,730	4,406	3,767	4,463
Shpenzimet e personelit	2,793	3,109	3,198	3,274	3,466
Shpenzimet e zhvlerësimit	859	834	863	1827	2277
Gjithsej shpenzimet operative	7,733	8,673	8,467	8,868	10,206

Figura 11. Shpenzimet operative, 2016-2020;



Të gjithë shifrat janë në '000 Euro.



Gjatë vitit 2020, vendi ynë sikurse të gjitha vendet e tjera është ballafaquar me pandeminë Covid-19. Kjo pandemi është reflektuar edhe në sektorin bankar, gjë që ka ndikuar në rritje të shpenzimeve operative në nivel të Bankës, me qëllim të zbatimit të masave të institucioneve publike për mbrojtje të klientëve dhe punonjësve tanë, duke siguruar ofrim të vazhdueshëm të shërbimeve në degët e bankës tonë.

Të gjitha këto kanë ndikuar në rritje të shpenzimeve operative të bankës gjatë vitit 2020.

Përkundër situatës pandemike, Banka jonë i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe investimeve në degë dhe infrastrukturë, investimeve në teknologji informative por në të njëjtën kohë edhe në zhvillimin dhe trajnimin e personelit. Këto kanë ndikuar në rritje të shpenzimeve të përgjithshme operative të bankës dhe rritje të shpenzimeve të zhvlerësimit të aseteve në krahasim me vitin paraprak. Banka jonë ndër të tjera i ka kushtuar rëndësi të veçantë donacioneve për pjesët e prekura të shoqërisë në mënyrë që sadopak të bëhet më e lehtë tejkalimi i pandemisë në këto kohë të vështira.

Megjithatë, rishikimi i shpenzimeve operative edhe këtë vit ka qenë prioritet dhe ka përfshirë rritjen e efijencës dhe efektivitetit, gjithmonë duke qenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat për t'i plotësuar sa më mirë kërkesat dhe nevojat e klientëve tanë.



Monedhë epirote të kohës së mbretit Pirro

ZHVILLIMI I BIZNESIT

Gjatë vitit 2020, Banka jonë i ka kushtuar kujdes të shtuar zhvillimit dhe zgjerimit të vazhdueshëm dhe të mirëfilltë të departamenteve të cilat janë përgjegjës për zhvillimin e biznesit. Në këtë drejtim, fokusi ka qenë tek përmbushja e kërkesave dhe nevojave të klientëve institucional, kërkesa këto të cilat u trajtuan në kuadër të Departamentit të Korporatës.

Duke parë rrethanat e krijuara me pandemi, me qëllim të ofrimit të lehtësirave për klientët tanë, në pajtueshmëri me rekomandimet e BQK-së, ne kemi bërë shtyrje të përkohshme të pagesës së kësteve kreditore për individë dhe biznese të cilët për shkak të situatës së krijuar kishin vështirësi në pagesat e rregullta të kësteve kreditore, pa interes ndëshkues.

Si pjesë e strategjisë së Bankës, pavarësisht sfidave dhe rrethanave të krijuara si rezultat i pandemisë Covid-19, Departamenti për Individë ka vijuar me një sërë fushatash dhe iniciativash të cilat mbështesin nevojat e klientëve drejt realizimit të planeve të tyre investuese. Në këtë drejtim, me punonjës të specializuar për shërbim të klientëve me kategori të ndryshme të të hyrave dhe asetëve, kemi arritur të realizojmë synimet tona strategjike të rritjes së kredive dhe depozitave, si dhe mirëmbajtjes së nivelit të normave të kredive joperformuese, përkundër vështirësive të krijuara nga pandemia.

Përgjatë vitit 2020 është bërë rishikimi i produkteve dhe shërbimeve, duke mos u ofruar klientëve të korporatave tashmë vetëm shërbime klasike financiare, por një gamë të gjerë shërbimesh, sipas kërkesave dhe specifikave që u nevojiten. Duke parë rëndësinë e këtij segmenti të klientëve, Banka do të vazhdojë të zhvillojë dhe përshtatë produktet dhe shërbimet e saj në përkrahje të këtyre bizneseve.

Ndërsa, në aspektin e bizneseve të vogla dhe të mesme, në një ambient të pasigurt të krijuar nga pandemia, Banka jonë demonstroi besim në kapacitetet e bizneseve dhe mirëmbajti kreditimin e tyre. Krahas kësaj, u vazhdua me iniciativat e segmentimit të filluara në 2019 ku gjatë vitit 2020 u proflizua departamenti Agro duke rritur kështu resurset e specializuara në sektorin Agro. Në të bërit biznes, u intensifikua shfrytëzimi i fondit garantues si instrument për rritje të qasjes në financim për bizneset dhe me këtë edhe tejkalimi i kufizimeve për klientët të cilët kishin vështirësi për sigurimin e kolateralit. Të gjitha këto zhvillime të kombinuara me fushatat specifike kontribuan që përkundër rënies ekonomike në nivel vendi, të kemi rritje të ekspozimit kreditor për 10.2 milionë euro, gjithmonë duke mirëmbajtur normat e kredive joperformuese si para pandemisë.

Në vitin 2020 është themeluar Departamenti i Lizingut i cili në vitin 2019 ishte njësi në kuadër të zhvillimit të biznesit. Duke parë potencialin dhe mundësinë e zgjerimit të gamës së produkteve bankare si dhe plotësimin e kërkesave të klientëve të bankës, ky produkt ka bërë që përveç plotësimit të kërkesave të klientëve ekzistues të bankës të sjell edhe klient të ri në bankë. Në fund të vitit 2020 numri i kontratave aktive të produktit ishte 492 dhe portfolio aktive në fund të vitit 2020 ishte 7.1 milionë Euro.

GJITHSEJ KREDITË

Gjatë vitit 2020, Banka jonë arriti të ketë një performancë të kënaqshme të të gjitha segmenteve të kreditimit. Rritja e bazës së portfolios dhe cilësisë së saj janë tregues se Banka jonë ka modelin e duhur të biznesit dhe në të ardhmen, sipas strategjisë, do të rris resurset në këtë drejtim. Rritja e portfolios kreditore ishte e shpërndarë tek të gjitha segmentet e biznesit, ku kemi edhe rritjen më të madhe të portfolios, nga 216 milionë sa ishte në vitin 2019, në 257 milionë në vitin 2020.

Segmenti	Ekspozimi kreditor 2019 në '000	Përqindja e participimit në 2019	Ekspozimi kreditor 2020 në '000	Përqindja e participimit në 2020
NVM	52,440	24.31%	62,560	24.33%
Lizing	4,155	1.93%	7,858	3.06%
Korporatë	79,170	36.70%	93,609	36.41%
Individë	79,949	37.06%	93,098	36.21%
Totali	215,714	100.00%	257,125	100.00%

KLIENTËT KORPORATË

Banka edhe gjatë vitit 2020 ka vazhduar të jetë një partner i besueshëm për klientët e të gjitha segmenteve, pavarësisht sfidave me pandeminë dhe masave të përcaktuara nga qeveria. Mirëpo, duke parë kërkesat gjithnjë në rritje të klientëve të korporatave si dhe kërkesat e tyre për produkte e shërbime më cilësore dhe profesionale, kemi zgjeruar personelin e Departamentit të Korporatës, për t'iu përgjigjur kështu pandërprerë nevojave të këtij segmenti, me zgjidhje të thjeshta dhe fleksibile.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2020 është bërë centralizimi i trajtimit të klientëve institucionalë (ndërmarrjet publike, OJQ, institucionet financiare, kompanitë e sigurimeve, etj), ku me këtë grup të klientëve ka filluar të merret ekskluzivisht Departamenti i Korporatës, që dëshmon se Banka vazhdon të jetë një partner i ngushtë jo vetëm i bizneseve private, mirëpo i të gjitha entiteteve juridike brenda territorit të Kosovës.

Në vitin 2020, biznesi në kuadër të Departamentit të Korporatës ka regjistruar një rritje të madhe në portfolion kreditorë, duke rritur kreditë neto me 14.4 milionë euro ose 18.15 përqind krahasuar me vitin paraprak. Rrjedhimisht, gjatë vitit 2020 kishte edhe përmirësim të cilësisë së aseteve që rezultojnë në kredi joperformuese, e që përbëjnë vetëm 1.82 përqind të portfolios së kredive, me një rënie prej 9 përqind (apo 0.18 pikë të përqindjes) krahasuar me vitin paraprak, gjë e cila është arritur me monitorim të afërt të portfolios kreditorë, e posaçërisht duke ruajtur cilësinë e kredive.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është që vëmendje e vazhdueshme i kushtohet sigurimit të përputhshmërisë së plotë me kërkesat rregullatore.

KLIENTËT E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Prej prizmit të biznesit, viti 2020 paraqet një vit të vështirë për tu definuar pasi që është vit ku modeli i biznesit u testua maksimalisht si pasojë e pandemisë dhe si asnjëherë më parë kërkesat për adaptim ishin maksimale. Përkundër këtyre rrethanave, duke u bazuar në strategji të besimit tek klientët dhe ekonomia, departamenti i biznesit arriti që me sukses të rrisë numrin e resurseve nëpër degë, të ri-organizojë të njëjtat me fokus në Agro, të shënojë rritje të portfolios kreditorë dhe të mirëmbajë kualitetin e portfolios.

Duke parë rolin dhe potencialin e kompanive të segmentit NVM në ekonominë kosovare, Banka Ekonomike vendosi që të rrisë pjesëmarrjen në këtë treg duke rritur numrin e analistëve që zhvillojnë dhe shërbejnë këtë segment nga 35 në 45. Ky vendim për zgjerim u morr me objektivin që Banka të jetë konkurrese dhe të rrisë bazën e klientëve veçanërisht në segmentet mikro dhe agro. Për më tepër, me rritjen e resurseve, Banka vendosi që të profilizojë segmentin e Agro si njësi me procese dhe nevoja të veçanta me ç'rast u bë alokimi i 9 analistëve që merren enkas me Agro duke mbuluar kështu komplet territorin e Kosovës. Nëpërmjet këtyre ri-strukturimeve dhe ri-pozicionimeve të resurseve, besojmë që janë vendosur bazat për një rritje të shëndoshë dhe afatgjatë të këtij segmenti.

Në aspektin e performancës, si pasojë e zhvillimeve gjatë vitit dhe sfidave të parashtruara nga pandemia, fokusi i departamentit u orientua në menaxhimin e shtyrjeve të obligimeve bazuar në udhëzimet e BQK-së në njërin anë dhe zhvillimin e portfolios kreditorë në anën tjetër. Në këtë drejtim, mund të konstatojmë që viti ishte jashtëzakonisht i suksesshëm në menaxhimin e objektivave ku është realizuar shtyrja e kësteve në dy faza dhe përkundër sfidave të të bërit biznes arritëm një rritje në portfolio kreditorë prej 10.2 milionë euro ose 19.29 përqind. Me këto të dhëna, edhe një herë e dëshmuam që si bankë qëndrojmë afër klientëve tanë dhe përkushtohemi që të shërbejmë kërkesat e tyre.

Përkundër faktit që ka kaluar një kohë e shkurtë nga fillimi i pandemisë dhe shtyrjes së obligimeve, sinjalet e para sa i përket performancës së kredive janë pozitive. Në këtë drejtim, në krahasimin e të dhënave vjetore të kredive joperformuese, kemi mirëmbajtje të niveleve të vitit 2019 ku përqindja arrin në 4.58 përqind. Si institucion, besojmë që masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse dhe pakoja e rimëkëmbjes ekonomike kanë siguruar mjaftueshëm likuiditet që të vazhdojë trendi pozitiv i rimëkëmbjes. Si bankë, ashtu siç kemi vepruar në vitin 2020 edhe në vitin 2021 do të vazhdojmë të përkrahim projektet e klientëve tanë për zhvillim të biznesit.

KLIENTËT INDIVIDUALË

Në kuadër të strategjisë së bankës, klientët individual mbeten kategoria me fokus të theksuar në aspekt të plotësimit të nevojave të tyre përmes ofrimit të shërbimeve cilësore dhe produkteve konkurruese të harmonizuara me kërkesat e tyre. Në linjë me këtë, viti 2020 u përmbyll me progres shumë të kënaqshëm në aspekt të arritjes dhe realizimit të objektivave të vendosura. Përkundër sfidave të vazhdueshme të ndërlidhura me ngjarjet në nivel global të situatës pandemike, segmenti individëve prezantoi në treg një sërë fushatash të kredive individuale të cilat në fokus kishin klientët dhe preferencat e tyre në aspekt të përmbushjes së nevojave për investime afatshkurtra dhe afatgjate, të cilat kontribuan në rritjen e portfolios kreditorë dhe bazës së klientëve.

Në kuadër të rritjes së nivelit të kënaqshmërisë të klientëve, përkundër masave shtrënguese të vendosura në aspekt të kufizimit të numrit të stafit për shkak të pandemisë, ne kemi vijuar me ofrimin dhe fuqizimin e shërbimit cilësor ndaj klientëve nga stafi i shitjes i vendosur në të gjitha degët në Kosovë, gjë që është mirëpritur nga klientët dhe të njëjtën kohë është cilësuar si vlerë e shtuar.

Për të vijuar më tej, objektivë strategjike shumë me rendësi për zhvillimin e biznesit në bankë janë depozitat. Fokusi ynë në ruajtjen e nivelit të projektuar të likuiditetit ka rezultuar të jetë i suksesshëm, ku gjatë vitit të kaluar, përkundër sfidave të sipërpërmendura, depozitat e klientëve individual kanë shënuar një rritje prej rreth 20 milion euro në total depozita. Ky angazhim i kurorëzuar me këtë rritje, përveç që përmbush objektivat tona strategjike, po ashtu dëshmon besimin e klientëve në Bankën Ekonomike.

Të gjitha përpjekjet dhe angazhimet përgjatë vitit të kaluar, përkundër sfidave të të bërit biznes, janë përkthyer në suksese të jashtëzakonshme, ku kemi rritjen më të lartë ndër vite deri më tani, në vlerë prej 13.5 milionë apo në pikë përqindje prej 16.90 përqind, që njëherazi është 11.30 përqind më e lartë se niveli i tregut, respektivisht 5.50 pikë të përqindjes.

LIZINGU

Më qëllim të zgjerimit të gamës së produkteve dhe shërbimeve bankare për klientët tanë, kemi vazhduar me konsolidimin e mëtejme të shërbimit të lizingut, duke vazhduar financimin e nevojave të klientëve përmes lizingut.

Si Departament i ri, vëmendje të veçantë i kemi kushtuar zgjerimit të resurseve tona, përfshirë atyre njerëzore dhe infrastrukturore, ku përmes financimit të klientëve tanë kemi ndikuar edhe në rritjen e aktivitetit ekonomik.

Të gjitha këto përpjekje përgjatë vitit u dëshmuar si të duhura dhe të suksesshme duke dhënë rezultate të kënaqshme përkundër sfidave të vitit 2020. Përmes lizingut, Banka ka arritur të gjenerojë klient të rinj, limite të reja dhe rritje të ekspozimit kreditor. Në kuadër të këtij departamenti dhe produkti, është arritur që numri i kontratave aktive të jetë 492 dhe total portfolio aktive 7.1 milionë euro, ndërsa deri në të njëjtën periudhë janë lejuar total 9.1 milionë euro.

Bazuar në ecurinë e deritanishme dhe potencialin për zhvillim të mëtejme, Banka do të vazhdoj edhe më tutje me rritjen e resurseve dhe fokusit në shërbimin e Lizingut, përfshirë kështu zgjerimin e gamës së produkteve të ofruar me lizing.

Duke e parë si produkt me potencial të madh dhe me rritjen e kërkesës për këtë produkt, në vitet e ardhshme do të punohet në rritjen dhe zhvillimin e këtij departamenti, resurseve të tij si dhe proporcionalisht me portfolion dhe gamën e produkteve të reja.

PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E KORPORATAVE

Përgjegjësia shoqërore e korporatave ka qenë gjithmonë një nga parimet themelore të Bankës Ekonomike, si një nga vlerat kyçe, duke kombinuar suksesin financiar me veprimet me përgjegjësi sociale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e mirëqenies dhe vetëdijes së përgjithshme.

Viti 2020 ishte një vit shumë sfidues në të gjitha drejtimet si pasoj e pandemisë Covid-19. Si shoqëri jemi përballur me nevojën që të qëndrojmë pran njëri-tjetrit, si asnjëherë më parë, duke e theksuar edhe më shumë rëndësinë e mbështetjes si për punonjësit tanë, klientët, qytetarët dhe më e rëndësishmja profesionistët shëndetësor dhe të gjitha institucionet dhe akterët të cilët ishin në vijën e parë në përballjen me Covid-19.

Si pasoj e pandemisë, detyrimisht kemi zgjeruar mbështetjen tonë për institucionet relevante shëndetësore, edukativo-arsimore dhe jo vetëm kaq, por nuk jemi ndalur edhe në mbështetjen e aktiviteteve tjera me karakter social, kulturor, sportiv, pa i harruar edhe kategoritë e marginalizuara. Si e vetmja bankë me kapital 100 përqind vendor, Banka Ekonomike do të vazhdoj të luaj rol shumë të rëndësishëm në rimëkëmbjen e shoqërisë sonë.

Mbështetja për shëndetësinë

Duke e parë rrezikun e vazhdueshëm me të cilin përballen çdo ditë profesionistët tanë shëndetësorë dhe qytetarët, dhe me qëllim që të kontribuoj në vazhdimësi në luftën kundër Covid-19, Banka jonë ka dhuruar një "Tunel Dezinfectues" si donacion për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitarë të Kosovës - SHSKUK, i cili është vendosur në hyrje të Klinikës Emergjente, për t'u shfrytëzuar nga punonjësit shëndetësor dhe qytetarët.



Ky "Tunel Dezinfektues" është mirëmbajtur nga Banka jonë gjatë gjithë vitit 2020.

Po ashtu kemi kontribuar përmes fushatave edhe thirrjeve për respektim të masave të vendosura nga institucionet relevante.

Mbështetja për nxënësit e Komunës së Prishtinës

Duke parë nevojën për mbështetje pas rrethanave të krijuara si pasojë e Covid-19, Banka jonë në kuadër të përgjegjësisë shoqërore ka vendosur t'i bashkohet iniciativës së Komunës së Prishtinës për të ndihmuar nxënësit në nevojë të cilët nuk mund të përfshiheshin në mësimin online me bashkëmoshatarët e tyre. Me këtë rast Banka jonë ka dhuruar një numër të tabletëve si donacion për Komunën e Prishtinës, të cilët do t'u shpërndahen nxënësve të Prishtinës.

Mbështetja për veprimtarit sociale

Në kuadër të përgjegjësisë shoqërore, Banka Ekonomike ka vazhduar të mbështesë kategori të ndryshme të shoqërisë sonë, mision ky të cilin e kemi fokus të veçantë.

Në këtë drejtim, Banka jonë ka dhuruar një donacion me pajisje kompjuterike të nevojshme për punën e komitetit të grave të verbra të Kosovës. Ky donacion, do të lehtësoj dhe do të ndihmojë funksionimin e komitetit, duke përmirësuar edhe më shumë infrastrukturën e punës, si dhe këto pajisje do të shfrytëzohen për trajnime për gratë e komitetit.

Mbështetja për SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës

Fëmijët janë pasuria më e rëndësishme e shoqërisë, andaj përkrahja dhe përkujdesja shoqërore janë komponentë e rëndësishme për zhvillim dhe mirëqenie. Gjatë vitit 2020, duke pas parasysh edhe pasojat që ka lënë pandemia Covid-19, e kemi rritur edhe më shumë mbështetjen për këto kategori shoqërore, me qëllim që të ju bëjmë më të lehtë tejkalimin e pasojave të Covid-19.

Banka Ekonomike sikurse edhe në të kaluarën, ka dhuruar donacion për Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës, që është një organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve të braktisur dhe nevojtarë pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar. Fondacioni SOS Fshatrat

e Fëmijëve në Kosovë vepron nga viti 1999 dhe deri tani është përkujdesur për mbi 1000 fëmijë të braktisur, pa përkujdesje prindërore dhe nevojtarë.

Mbështetja për Asociacionin Nacional të Autizmit në Kosovë

Banka Ekonomike në kuadër të përgjegjësisë shoqërore ka vazhduar me mbështetjen e kategorive shoqërore të cilat ndërlidhen me fëmijët, konkretisht edukimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre.

Në këtë drejtim, Banka jonë i është bashkuar kampanjës #PërNjëriTjetrin të iniciuar nga Asociacioni Nacional i Autizmit Kosovë, duke bërë një donacion në mbështetje të fëmijëve të prekur nga autizmi.

Asociacioni Nacional i Autizmit Kosovë (ANAK), ka filluar ofrimin e shërbimeve emergjente për fëmijë me autizëm në prill të vitit 2012 kryesisht në baza vullnetare, nga profesionistët e fushës së psikologjisë klinike, psikologjisë së fëmijëve, Departamentit të Psikologjisë dhe ekspertë të psikiatrisë së fëmijëve.

Mbështetja për fëmijët me sindromë Down

Duke qenë të vetëdijshëm për sfidat me të cilat përballen fëmijët me sindromë Down dhe nevojën për mbështetje institucionale, veçanërisht pas rrethanave edhe më të vështira që ka krijuar pandemia Covid-19, Banka jonë në kuadër të përgjegjësisë shoqërore ashtu sikurse edhe vitet e kaluara edhe në vitin 2020 ka vazhduar mbështetjen për “Down Syndrome Kosova” duke dhuruar një donacion përmes të cilit synohet të ndikohet drejtpërdrejtë në integrimin e mëtejshëm në shoqëri dhe vazhdim të qasjes në shërbimet terapeutike për fëmijët me sindromën Down.

Shoqata “Down Syndrome Kosova” numëron mbi 980 anëtarë dhe ka shtrirje në katër regjione: Prishtinë, Prizren, Ferizaj dhe Mitrovicë, ku rreth 300 anëtarë marrin shërbimet e nevojshme në këto qendra.

Mbështetja për Shoqatën Handikos

Banka Ekonomike ka vazhduar me ofrimin e mbështetjes për kategoritë shoqërore të cilat kanë nevojë për kujdes të veçantë, duke synuar përmbushjen e misionit për përgjegjësinë shoqërore. Gjatë vitit 2020, Banka jonë ka dhuruar një donacion edhe për Shoqatën Handikos.

Përmes këtij donacioni do të krijohen mundësi më të mira për personat me aftësi të kufizuara të cilëve nga Handikos, fal angazhimit të stafit profesional do të iu mundësohet të marrin shërbimet esenciale, veçanërisht në përshtatjen e karrocave sipas diagnozës së personave.

Mbështetja për sportin

Sporti është burim i rekreacionit, që ofron argëtim, aktivitet fizik dhe inkurajon forcimin e shpirtit ekipor. Gjithashtu, mund të krijojë një ndjenjë të unitetit dhe pjesë të të qenit diçka më shumë se vetja. Andaj, duke i pasur këto parasys, Banka jonë vazhdimisht është vënë në përkrahje të sportit vendor.

Edhe gjatë vitit 2020 kemi vazhduar mbështetjen tonë në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të sportit. Sporti femëror pa dyshim se ka nevojë për mbështetjen dhe promovimin institucional, andaj në drejtim të kësaj, me qëllim të përmirësimit të kushteve për zhvillimin e aktivitetit dhe masivizim të sportit femëror, Banka Ekonomike ka vendosur të mbështes Klubin e Volejbollit “M-Technologie” përmes sponsorizimit.

Ndërsa, futboli si sporti më i popullarizuar, për zhvillim të mëtejshëm, rritje të cilësisë dhe masivizim, pa dyshim se ka nevojë për mbështetje institucionale, e në këtë drejtim, Banka jonë ka vendosur të mbështes projektin e Klubit të futbollit “Shkëndija”.

Një tjetër sport të cilit i kemi kushtuar rëndësi është edhe futsalli, ku kemi mbështetur FC Prishtina Futsall të cilët gjatë vitit 2020 ishin kampion të Kosovës.



Mbështetja për kulturë

Fusha e kulturës është një tjetër segment të cilit Banka jonë i kushton rëndësi të veçantë. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2020 kemi mbështetur projektin më të ri i cili është në zhvillim e sipër, serialin “Kosovarët”.

Përmes këtij projekti filmik, i cili do të jetë prodhim vendor, i hartuar nga skenaristi dhe regjisori Amerikan Darren Denison, do të pasqyrohet rrugëtimi i vështirë i popullit shqiptar dhe lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisht të vendit tonë.

Ky projekt synon të transmetohet në audiencën vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim që të pasqyrohet lufta e drejtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

KANALET E DISTRIBUIMIT


Rrjeti i degëve

Teknologjia dhe digjitalizimi i operacioneve biznesore janë kërkesë e kohës, të cilën të gjithë po mundohen ta zbatojnë, mirëpo as afërsia me klientin nuk duhet lënë anash, sepse teknologjia asnjëherë nuk do të mund të zëvendësojë kontaktin human.

Andaj, bazuar në strategjinë tonë për të ofruar një infrastrukturë sa më moderne e cila përmbush nevojat dhe kërkesat e klientëve tanë, Banka jonë ka gjithsej 30 degë, të cilat janë të ndara në 7 degë kryesore dhe në 23 nëndegë. Sipas statistikave nga raporti i përgjithshëm i bankave, Banka Ekonomike renditet e 3-ta sipas prezencës në tregun bankar të Kosovës. Kjo dëshmon edhe një herë qëllimin e Bankës Ekonomike për të shërbyer çdo klientë të bankës, në çdo pjesë të vendit!



Për të qenë në hap me zhvillimet e fundit në ofrimin e shërbimeve më cilësore në tregun bankar në vend, Banka jonë i ka kushtuar rëndësi të veçantë rrjetit të degëve të bankës. Viti 2020 ishte një vit i vështirësive dhe i sfidave për të gjithë si pasojë e pandemisë, por pavarësisht rrethanave, mund të themi se Banka ka arritur objektivat e përafërta për vitin 2020 dhe ka vazhduar me trendin për rialokimin e degëve në pajtueshmëri me standardin e ri me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të shpejta dhe të lehta për klientët. Në aspektin e përmirësimit të infrastrukturës së rrjetit të degëve dhe hapësirave vetëshërbyese, kemi rialokuar nëndegën tek Menza në lokacionin e ri Mati 1 dhe nëndegën në Podujevë, nëndegën në Vushtrri të cilat tashmë ofrojnë një ambient të ngrohtë dhe modern për klientë.

Figura 12. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në numrin e degëve në tregun bankar.

Kanalet alternative të distribuimit

Qendra e Thirrjeve, si kanal alternativ dhe i rëndësishëm i shërbimit të klientëve, edhe gjatë vitit të kaluar ka luajtur rol të rëndësishëm në rritjen e ofrimit të shërbimeve dhe plotësimin e kërkesave të klientëve 24 orë për 7 ditë të javës. Viti 2020 ishte sfidë për të gjithë si rrjedhojë e pandemisë Covid-19, duke pas parasysh kufizimin e lëvizjes dhe mbylljen e institucioneve, përkundër kësaj Qendra e Thirrjeve nuk ka pushuar së funksionuari në ofrimin e shërbimeve dhe informacioneve të ndryshme për klientët e Bankës dhe atyre potencial në të ardhmen.

Përmes Qendrës së Thirrjeve, Banka jonë ka pranuar 11,483 kërkesa nga klientët si dhe ka ofruar sqarime dhe udhëzime këshilluese rreth produkteve dhe ofertave të bankës.

Në vazhden e fuqizimit të bankimit direkt, Banka jonë edhe në të ardhmen do të vazhdoj me fuqizimin dhe ngritjen cilësore të këtij shërbimi.

Në fokus gjatë vitit 2020 ishin sigurimi i shërbimeve profesionale, përkrahja e veprimtarisë afariste dhe rritja e besueshmërisë së klientëve, duke zhvilluar marrëdhënie afatgjata me klientët. Krahas qendrës së thirrjeve, Banka Ekonomike u ka ofruar klientëve përkrahje dhe përkujdes edhe përmes rrjeteve sociale, që tashmë është një kanal shumë i rëndësishëm dhe praktik.

Në kuadër të përmirësimit të shërbimit për klientët tanë dhe mbulimit sa më të mirë të gjithë territorit të vendit tonë, për të qenë sa më afër klientëve tanë, kemi investuar në rrjetin e ATM-ve, ku përmes 51 ATM-ve në gjithë vendin ofrojmë një infrastrukturë të kënaqshme të shërbimit, në çdo kohë.

Sa i përket pjesëmarrjes në tregun bankar, për nga numri i ATM-ve, marrim pjesë me 11 përqind të tregut. Duke qenë në trend me avancimet teknologjike si dhe dinamikës jetësore, një ndër prioritetet kryesore për Bankën Ekonomike ka qenë fokusimi në ofrimin e shërbimeve në çdo kohë 24/7 përmes bankomatëve.



Monedhë epirote të kohës së mbretit Pirro

Në vitin 2020, deponimi i mjeteve në bankomate është më i lartë në krahasim me vitin paraprak. Viti 2020 ka rritje për 64.41 përqind në numër të deponimeve në krahasim me vitin paraprak.

Gjatë vitit 2020, në përgjithësi të gjitha llojet e transaksioneve me kartela (deponim, tërheqje dhe blerje) në bankomate kanë pasur rritje si në numër ashtu edhe në vlerë. Në vitin 2020, numri i tërheqjeve është rritur për 6.22 përqind në krahasim me vitin paraprak.

Në hap me zhvillimin e tregut bankar drejt digjitalizimit të ofrimit të shërbimeve, Banka jonë gjatë vitit 2020 ka vazhduar me zgjerimin e rrjetit të hapësirave vetëshërbyese, me qëllim të qasjes sa më të lehtë në kryerjen e shërbimeve për klientët, në çdo kohë përgjatë 24 orëve. Banka jonë ka 10 hapësira vetëshërbyese për klientët tanë.

Për të kompletuar ofrimin e shërbimeve cilësore për klientët, Banka jonë ka një ekip të përkushtuar në çdo degë që siguron që çdo shërbim ofrohet në mënyrë të duhur dhe çdo kërkesë e klientëve adresohet me kujdes.

MENAXHIMI I RREZIKUT

Viti 2020 është theksuar si një vit me sfida të reja të shkaktuara si pasojë e Covid-19 me ndikim në operacionet e Bankës dhe performancën kreditore të Bankës dhe sektorit financiar në përgjithësi. Si rezultat i pandemisë, ekonomia kosovare, por edhe ajo globale, ka qenë e ndikuar negativisht duke krijuar ulje të kërkesës agregate të konsumit, që si rezultat ka ndikuar negativisht edhe në nivelin e investimeve në nivel vendi. Po ashtu, pandemia ka ekspozuar disa sektorë më të ndjeshëm që janë prekur më shumë si rezultat i masave të vendosura për parandalimin e pandemisë, ndërsa gjatë kësaj kohe Banka ka pasur kujdes të shtuar në kreditimin e sektorëve të caktuar.

Ne anën tjetër, masat e ndërmarra nga Banka si rezultat i vendimeve të Bankës Qendrore të Kosovës dhe mundësisë së aplikimit për shtyrje të pagesave dhe ofrimi i riprogramimit të kredive për sektorë/individë të prekur nga pandemia, kanë pasur efekt pozitiv në parandalimin e përkeqësimit të treguesve kreditor në nivel të Bankës dhe në nivel të sistemit financiar në përgjithësi.

Procesi i menaxhimit të rrezikut përfshin menaxhimin e rrezikut kreditor, operacional, të tregut, likuiditetit, investimeve apo rreziqeve të tjera ndaj të cilave banka mund të ekspozohet në çdo kohë. Më qëllim të

arritjes së synimeve strategjike, dokumentet vjetore përfshirë strategjinë dhe politikat, janë hartuar dhe i janë përshtatur situatës me Covid-19 për çdo rrezik specifik në mënyrë që të mirëmbahen treguesit kyç të rrezikut, të kontrollohen dhe monitorohen në baza të rregullta, gjithnjë duke pas për bazë kapitalin e disponueshëm të bankës. Performanca dhe stabiliteti financiar i bankës është e qëndrueshme, bazuar në treguesit kryesor të rreziqeve:

Gjithsej kapitali në raport me mjetet e rrezikuara	13.03%
Niveli i kredive joperformuese	2.46%
Raporti kredi me depozita	77.37%
Rezervat në raport me kreditë joperformuese	158%

Po ashtu, gjatë këtij viti është zbatuar përputhshmëria me infrastrukturën rregullative dhe ligjore, duke përshtatur të gjitha kërkesat që rrjedhin nga kërkesat e rregullatorit apo standardet ndërkombëtare. Kalkulimi i humbjeve (provizioneve) është avancuar në përputhje me standardet e reja ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) i cili përfshin sistemin e tërësishëm për matje, klasifikim apo njohje të humbjeve të pritura.

Menaxhimi i Rrezikut Kreditor

Banka Ekonomike është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor, që është ndër rreziqet me materiale dhe më me ndikim në performancën e përgjithshme të Bankës. Në anën tjetër, Banka është e ekspozuar ndaj tregjeve financiare përmes aktiviteteve të thesarit dhe kryesisht investimeve në letrat me vlerë të Republikës së Kosovës. Banka si proces të rregullt e bënë identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut kreditor dhe ka krijuar mekanizma për menaxhimin dhe monitorimin e riskut kreditor. Banka po ashtu ka parasysh koncentrimin e rrezikut kreditor, duke marrë për bazë diversifikimin e portofolios kreditorë nëpër industri dhe profile të ndryshme, që mund të vi si pasojë e ndryshimeve makro-ekonomike apo faktorëve të jashtëm. Si rezultat i politikave kreditorë të aprovuara nga Banka, limiti maksimal i kredisë për një klient apo grup të ndërlidhur të klientëve gjithnjë mbahet nën limitet e rregullatorit, duke zvogëluar kështu rrezikun e koncentrimin të kredisë. Limitet e tilla janë të aprovuara paraprakisht nga Bordi i Drejtorëve dhe monitorohen dhe raportohen rregullisht në Komitetin për Menaxhimin e Rrezikut.

Për këtë qëllim, Banka ka bërë diversifikimin e portfolios kreditorë të ndërmarrjeve dhe ka alokuar një pjesë të portfolios kreditorë në ekonomitë familjare dhe ka përkrahur rritjen e segmentit të lizingut financiar. Po ashtu, Banka ka shfrytëzuar mundësinë e transferimit të rrezikut kreditor tek palët e treta duke shfrytëzuar mundësinë e financimit nëpërmjet Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë, që paraqet një mjet shumë efikas për zbutjen e rrezikut kreditor, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë.

Menaxhimi i kredive jo-performuese në fundvit pësoi një rritje të vogël nga 2.41 përqind (dhjetor 2019) në 2.46 përqind (dhjetor 2020). Ky trend ishte i qëndrueshëm, kur merren parasysh efektet e shkaktuara nga pandemia dhe masat e përkohshme të mbylljes së ekonomisë gjatë tremujorit të dytë të vitit.

Menaxhimi i rrezikut kreditor bëhet përmes vlerësimit të vazhdueshëm të aftësisë kreditorë të huamarrësve ndërsa ekspozimet kreditorë >50,000 euro monitorohen së paku në baza vjetore. Departamenti për Riskun Kreditor ka për qëllim të menaxhojë cilësinë e portfolios kreditorë në përputhje me rregulloret e BQK-së, si dhe politikat dhe procedurat e aprovuara nga Banka. Procesi i aprovimit dhe monitorimit të kredive është i decentralizuar në degë sipas limiteve të përcaktuar nga menaxhmenti i bankës, ndërsa ekspozimet kreditorë >10,000 euro vlerësohen nga Departamenti për Riskun Kreditor në bashkëpunim të ngushtë me linjat e biznesit dhe menaxhmentin e Bankës. Në delegimin e autoriteteve të kredisë, zbatohet parimi i “katër syve”, ndërsa në komitetet e kredive vendimet duhet të merren në mënyrë unanime. Një nga komponentët e rëndësishme të qeverisjes për korporata është parimi i kontrolleve në nivel dege dhe proceset që kanë të bëjnë me kreditim, të cilat kryhen me kujdesin e duhur profesional.

Për më shumë, është funksionalizuar njësia e kolateralit e cila merret me trajtimin e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, procesit të vlerësimit dhe rivlerësimit, si dhe monitorimit të tyre në baza të rregullta.



RREZIKU OPERACIONAL

Rreziku operacional përkufizohet ndryshe edhe si rreziku i humbjeve të shkaktuara nga proceset e brendshme jo adekuate apo të dështuara të njerëzve, sistemeve dhe ngjarjeve të jashtme. Banka ka një sistem të zhvilluar të rrezikut operacional që i përshtatet natyrës të Bankës sa i përket identifikimit të treguesve kyç të rrezikut dhe kontrollit të vazhdueshëm të incidenteve të rrezikut operacional, me të vetmin qëllim që të zvogëlojë ndikimin financiar dhe shpeshtësinë e incidenteve.

Banka vazhdon të mbetet e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme operationale, si pasojë e avancimeve teknologjike në fushën e shërbimeve financiare, ndër të tjera, që e kanë bërë këtë rrezik më të ndjeshëm ndaj proceseve të brendshme jo adekuate apo të dështuara të njerëzve, sistemeve dhe ngjarjeve të jashtme.

Për të vendosur kontroll më efektiv mbi rrezikun operacional nevojitet aftësia për të vlerësuar profilin ekzistues të rrezikut të bankës nëpërmjet kategorizimit të këtyre incidenteve në bazën e të dhënave, përfshirë këtu edhe ngjarjet që çojnë drejt rrezikut potencial operacional. Për më tepër, Banka ka instaluar standarde të larta të monitorimit të rrezikut operacional kundrejt raportimeve dhe ofron trajnime të vazhdueshme mbi rrezikun operacional për gjithë punonjësit, e veçanërisht për ata që janë përgjegjës për raportimin e incidenteve të rrezikut operacional dhe punëtorët e rinj. Përmes qasjeve të standardizuara në menaxhim të rrezikut operacional kemi arritur përmirësim të dukshëm në cilësinë e të dhënave si pikë kyçe në vendimmarrje në raport me incidentet e paraqitura në komitetet e rrezikut operacional.

Andaj, me gjithë rritjen e vazhdueshme të ekspozimit ndaj rrezikut operacional, menaxhimi i këtij rreziku ishte adekuat, duke izoluar pasojat e tij si rezultat i aktiviteteve të ndara sipas standardit të Bazelit. Banka ka arritur të ndërmarrë hapa kundrejt një kontrolli sa më efektiv mbi menaxhimin e rrezikut operacional, duke zbatuar plotësisht vetë vlerësimin e profilit ekzistues të rrezikut të bankës.

RREZIKU I LIKUDITETIT DHE TREGUT

Rreziku i likuiditetit shfaqet kur nuk ka mjete të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e financimit në kohën e duhur. Po ashtu mund të ndodhë edhe kur pozicionet e hapura nuk mund të mbyllen në kohë me çmime të përshtatshme. Në anën tjetër, si pjesë e rrezikut të tregut shfaqet kur një pasuri e Bankës mund të humbas në vlerë për shkak të ndryshimit të normës së interesit.

Burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditor vazhdon të përfaqësohet nga depozitat afatshkurtra të cilat shënuan rritje, kryesisht nga ekonomitë familjare në raport me depozitat e personave juridik duke krijuar një likuiditet të qëndrueshëm për bankën. Afatet e maturimit të depozitave dhe kredive theksojnë mospërputhjet strukturore ndërmjet tyre, të cilat janë më të shprehura tek afatet "mbi 1 vit". Depozitat me afat maturimit "deri në 1 vit", dominuan strukturën e depozitave të afatizuara. Për të njëjtin qëllim është ndërtuar modeli i klasifikimit (shtresimit) të depozitave për qëndrueshmëri afatgjate në bankë. Raportet në mes depozitave dhe ekspozimeve kreditore vazhdojnë të kenë shpërputhje dhe rritje të rrezikut sidomos tek pjesa e interesit për ekspozime kreditore afatgjate, prandaj është zbatuar produkti i normës variabile të interesit me qëllim të menaxhimit të hendekut dhe konkurrencës sa u përket lëvizjeve të normave të interesit.

Investimet kryesore gjatë kësaj periudhe karakterizuan investimet në letra me vlerë dhe bonot e thesarit të Republikës së Kosovës. Tabela më poshtë paraqet ekspozimin ndaj letrave me vlerë të Republikës së Kosovës.

000 euro	2019	2020
T-Bonds të Republikës së Kosovës	25,005	25,285
T-Bills të Republikës së Kosovës	5,201	-

Rezervat e likuiditetit vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 35.7 përqind, në raport me kërkesën ligjore prej 25 përqind. Banka është e likuide sepse ka aftësinë që me kohë të përmbush detyrimet aktuale dhe të ardhshme. Gjatë gjithë periudhës janë mirëmbajtur limitet e përcaktuara nga rregullatori, si dhe në baza të rregullta janë monitoruar indikatorët kyç të likuiditetit të cilat japin sinjale pozitive për stabilitet në bankë. Në anën tjetër, si pjesë e Bazeli III, Banka kalkulon në baza të rregullta raportin e mbulueshmërisë së likuiditetit duke siguruar që Banka është duke e mbajtur raportin e LCR >100 përqind.

Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit

Banka ka hartuar dokumentin i cili si koncept ka për qëllim të identifikojë, vlerësojë dhe menaxhojë të gjitha rreziqet sipas shtyllës së dytë të standardeve të Bazelit për mjaftueshmërinë e kapitalit. Ky proces i standardizuar i vlerësimit të brendshëm është i rëndësishëm për planifikimin e kërkesave minimale për kapital ndaj të cilave Banka është e ekspozuar apo mund të ekspozohet në mënyrë që të vazhdojë me operacione të rregullta të biznesit. Rreziqet individuale që rrjedhin prej modelit apo strategjisë gjatë kohëzgjatjes së planit të biznesit, koncentrimi i portfolios kreditore, kolaterali, risku operacional, likuiditeti, norma e interesit, përcakton nevojën e planifikimit të kapitalit për këto rreziqe.

Komiteti për Menaxhim të Rrezikut (KMR)

Në baza të rregullta të gjitha aktivitetet e ndërmarra për menaxhim të rrezikut diskutohen dhe raportohen në KMR në nivel të Bordit të Drejtorëve. KMR është organ më i lartë sa i përket mbikëqyrjes së Bankës për aktivitetet e rrezikut. Të gjitha politikat për menaxhim të çdo rreziku specifik, limitet, treguesit e rrezikut analizohen, vlerësohen dhe paraprakisht validohen nga KMR dhe në fund rekomandohen për aprovim tek Bordi i Drejtorëve të Bankës.

OPERACIONET DHE PAGESAT

Edhe pse viti 2020 ka qenë vit i pandemisë dhe vit i sfidave që ka sjell pandemia Covid-19, Banka Ekonomike ka vazhduar përqendrimin në shërbimin e klientëve dhe stabilitetin e funksioneve operacionale duke zhvilluar dhe zbatuar një numër të projekteve zhvillimore që kanë të bëjnë me përmirësimin e proceseve të bankës dhe plotësimin e kërkesave ligjore vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Me këtë Banka Ekonomike vazhdon të jetë konkurrenente në treg, duke qenë e orientuar drejt përmirësimit të mëtejshëm të infrastrukturës së shërbimeve ndaj klientëve të vet.

Kemi zbatuar platformën e “webservice” të kompanisë rajonale të ujësjellësit të Prishtinës (KRU), përmes të cilit mundësohet realizimi i pagesave online për pagesën e faturave të ujit.


SWIFT GPI - një standard të ri i zbatuar për transferet ndërkombëtare përmes SWIFT-it, meqë rast Bankës Ekonomike i mundësohet menaxhimi i plotë dhe i shpejtë i transfereve hyrëse dhe dalëse të klientëve të saj që nga inicimi deri tek pranimi i pagesës.

Po ashtu, Banka Ekonomike gjatë vitit 2020 ka vazhduar me procesin e personalizimit të kartelave të klientëve brenda Kosovës për kategorinë e pensionistëve. Gjithashtu, kemi investuar në rritjen e efijencës së prodhimit të kartelës nga aplikimi deri tek dorëzimi i kartelës tek klienti.

TRANSFERET KOMBËTARE

Vlera e përgjithshme e transfereve hyrëse dhe dalëse nga 1.02 miliardë sa ishte në vitin 2019 është rritur në 1.07 miliardë në vitin 2020, që përbënë një rritje prej rreth 4 përqind, e paraqitur edhe në tabelën më poshtë. Transferet hyrëse kanë pasur rritje prej 13 përqind, përderisa si rrjedhojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2020 transferet dalëse kombëtare të kryera në sportel kanë pësuar një rënie prej 3 përqind krahasuar me vitin paraprak. Në kuadër të strategjisë së Bankës tonë për avancim të mëtejme të automatizimit të proceseve dhe shfrytëzimit të kanaleve alternative, shfrytëzueshmëria e platformës E-Banking është rritur për 13 përqind.

Figura 13. Transfere kombëtare, hyrëse dhe dalëse;



Të gjitha shifrat janë në '000 Euro


TRANSFERET NDËRKOMBËTARE

Transferet ndërkombëtare në vitin 2020 kanë pasur rritje krahasuar me vitin paraprak. Numri i përgjithshëm i transfereve hyrëse dhe dalëse është rritur rreth 19 përqind, nga 18 mijë sa ishte në vitin 2019 në 22 mijë për vitin 2020.

Ndërsa vlera e përgjithshme e këtyre transaksioneve ka pasur rritje prej 15 përqind në vitin 2020 krahasuar me vitin paraprak, ku në total vlera e transfereve hyrëse dhe dalëse nga 275 milionë në vitin 2019 është rritur në 317 milionë në vitin 2020, siç është prezantuar në tabelën më poshtë.

Figura 14. Transfere ndërkombëtare, hyrëse dhe dalëse;

Transferet Ndërkombëtare Hyrëse dhe Dalese



Të gjitha shifrat janë në '000 Euro


KARTELAT BANKARE

Banka Ekonomike, ju ofron klientëve të vet kartela debit dhe kredit për kryerjen e shërbimeve brenda dhe jashtë vendit në bashkëpunim me partnerët e saj MasterCard dhe Visa si në bankomatë, POS terminale dhe pagesa online. Gjithashtu këtë vit ka lansuar edhe kartelat debitore lokale për kategorinë e pensionistëve të cilëve iu mundësohet procesi i tërheqjeve të mjeteve në bankomatët e Bankës Ekonomike.

Në krahasim me vitin e kaluar, numri i debit kartelave ka arritur në 73 mijë dhe ka shënuar rritje për 35 përqind apo për 18,821 debit kartela më shumë se sa në vitin paraprak, ndërsa numri i kredit kartelave ka arritur në 6,863 mijë apo një rritje për 28 përqind apo për 1,513 kredit kartela më shumë.

Gjatë vitit 2020 është dëshmuar edhe njëherë besimi i klientëve ndaj Bankës tonë ku kemi mbi 11000 klientë të rinjë të cilët kanë hapur llogari në Bankën tonë.

Figura 15. Numri i debit dhe kredit kartelave ndër vite.



Të gjitha shifrat janë në '000 Euro

SIGURIA E INFORMACIONIT DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Viti 2020 ishte ndër vitet më sfidauese për të gjithë pasi që pandemia Covid-19 pati shtrirje globale dhe preki në masë të madhe edhe vendin tonë. Në mënyrë që Banka të vazhdoj operacionet ditore dhe të jetë e qasshme për klientët edhe në rrethana jo të zakonshme, organizimi i vazhdimësisë së biznesit ishte shumë i rëndësishëm, duke punuar me punonjës të reduktuar dhe me masa shtesë për sigurinë e klientëve dhe punonjësve tanë. Gjithashtu, në funksion të ruajtjes së shëndetit, Banka jonë është fokusuar edhe në operimin 24/7 duke aplikuar strategji të punës nga distanca, përfshirë takime pune online në të gjitha nivelet e Bankës. Në vitin 2020, krahas pandemisë edhe aktivitetet kriminale kibernetike kanë qenë në rritje globale, meqë rast edhe ne si Bankë kemi bërë investime të mëdha në fushën kibernetike dhe modernizimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit për të qenë në hap me kohën si në mbrojtjet kibernetike ashtu edhe në ofrimin e shërbimeve teknologjike ndaj punëtorëve të bankës por edhe klientëve të saj.

Po ashtu, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, përkundër të gjitha sfidave me të cilat është përballur ka zbatuar një sërë projektesh, duke filluar nga kërkesat ligjore deri tek përmirësimet e infrastrukturës teknologjike për ofrim më të mirë dhe saktë të shërbimeve.

Gjithashtu, ekipi punues për zbatimin e sistemit të ri bankar ka vazhduar punën intensive me qëllim të arritjes së zbatimit të sistemit sipas strategjisë dhe afateve kohore të përcaktuara.

MENAXHIMI DHE TRAJNIMI I PERSONELIT

Viti 2020 ishte një vit sfidues jo vetëm për klientët tanë në kuptim të vazhdimësisë së bizneseve të tyre, por edhe për institucionin, punonjësit tanë dhe për vazhdimin e strategjisë dhe praktikave aktuale të Departamentit të Burimeve Njerëzore. Sfidat ishin edhe më të mëdha në pjesën e sektorit të shërbimeve financiare, për shkak të natyrës kritike të punës, që kërkon përfshirje të drejtpërdrejt në marrëdhëniet me klientë.

Ne arritëm të transferonim një pjesë të madhe të operacioneve kritike të kryera në Zyrën Qendrore në formën e punës nga shtëpia. Për një pjesë të madhe të punëtorëve, puna në distancë ishte një përvojë që po ndodhte për herë të parë.

Roli i Burimeve Njerëzore u desh të përkthehej në strategji të reja për t'u përshtatur me situatat e përditshme. Një prej elementeve kryesore që e përcolli këtë strategji ishte komunikimi i pandalshëm dhe i vazhdueshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore me secilin punonjës për të kuptuar sfidat dhe për të ndihmuar e mbështetur këtë komunikim mes të Departamenteve/Degëve përkatëse.

Departamenti i Burimeve Njerëzore u përball me sfida të ndryshme që nga dita e parë, sfida të cilat kërkuan angazhim të të gjitha palëve, koordinimin e vazhdueshëm për të mbështetur me rritje të kapaciteteve secilën prej hallkave të funksioneve, proceseve, degëve etj, qoftë nëpërmjet komunikimeve, ofrimit të zgjidhjeve problemeve dhe trajnimeve të ndryshme virtuale.

Të mësuarit me sfidat e punës nga shtëpia dhe të sfiduarit me kurajo të situatave të panjohura që i solli viti 2020 i konfirmuan vlerat e ekipit tonë dhe shtyllat kryesore mbi të cilat ngritët cilësia e shërbimit dhe marrëdhënia profesionale dhe e përgjegjshme me klientët që e kanë përzgjedhur stafin tonë si këshillues financiar për biznesin e tyre.

Disa prej faktorëve kyç që mbështetën kalimin me sukses të sfidave të lartpërmendura janë:



Besimi te punonjësit

Një nga sfidat më të mëdha dhe elementi thelbësor ishte gatishmëria e Bankës e për të besuar se punonjësit tanë do të jepnin rezultate edhe në kushtet e reja të veprimtarisë. Koncepti i punës në distancë u zhvillua menjëherë duke u mbështetur në besimin e punonjësve dhe Menaxhmentit.

Përballja me të panjohurën ofron disa mundësi zgjidhjesh të disponueshme, por zgjedhja e zgjidhjeve të duhura u konfirmua nga aftësia jonë për t'ju përshtatur ndryshimeve nëpërmjet hapave të qëndrueshëm drejt arritjes së qëllimeve.

Përgjatë vitit 2020, Departamenti i Burimeve Njerëzore u angazhua në rolin e këshilluesit të ri-organizimit të lidhshëm sipas nevojës si dhe proceseve të rekrutimit të stafit të ri, i cili nuk u ndërpre pavarësisht kushteve të diktuar.

Departamenti i Burimeve Njerëzore zhvilloi me sukses Trajnimet Hyrëse për Punëtorët e rinj.

Viti 2020 shënon shtimin e një elementi të ri, përkatësisht atë të kulturës të punës nga shtëpia, e cila u adaptua dhe u arrit të bëhej realitet me sukses vetëm nëpërmjet strukturave të qëndrueshme të bankës nën drejtimin e Menaxhmentit dhe Departamentit të Burimeve Njerëzore. Kjo kulturë u arrit nëpërmjet komunikimeve virtuale të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe jo vetëm, si dhe përmes organizimit të takimeve në platforma të ndryshme me qëllimin kryesor të mbajtjes së kontaktit të afërt me të gjithë punonjësit.

Materialet e trajnimeve kishin elemente të shtuar të trajtimit të shembujve me situatat e reja. Departamenti i Burimeve Njerëzore organizoi këto trajnime:

Biznesi

- Mirësjellja në biznes
- Trajtimi i ankesave të klientëve

Operacione

- Trajnim për pjesën teknike në sistem
- Trajnim në programin CIF

Vetëm me këtë qasje, kemi mundësuar që klientët dhe punonjësit tanë të jenë të arritshëm për të gjithë bashkëpunëtorët dhe anasjelltas, si dhe të ruhen nivelet e larta të sigurisë së institucionit dhe të informacionit.

Departamenti i Burimeve Njerëzore vijoi me planin vjetor të trajnimeve me pjesëmarrje fizike dhe virtuale. Operacionet ishin shumë të rëndësishme dhe për këtë arsye Departamenti i Burimeve Njerëzore vuri në fokus organizmin e trajnimeve me këtë tematikë, duke veçuar elementet e reja në përputhje me situatën e krijuar.

Lufta kundër pastrimit të parave, Siguria e Informacionit dhe Menaxhimi i rrezikut operacional nuk u la jashtë vëmendjes së Departamentit. Këto trajnime jo vetëm që u realizuan sipas kulturës së punës në distancë, por tepër e rëndësishme është edhe ndërgjegjësimi i secilit punonjës për këtë çështje, sidomos në kohën e pandemisë.

Pavarësisht pengesave, dinamikës së shtuar dhe qasjeve të zgjeruara në platformën virtuale, stafi i Bankës së bashku me Departamentin e Burimeve Njerëzore përmbyllen me sukses një sërë trajnimesh dhe programesh teknike të ofruara nga kolegët tanë si dhe nga palë të jashtme profesionale.



PAJTUESHMËRIA E PËRGJITHSHME

Viti 2020 ka qenë vit me plot sfida dhe të reja për gjithë sektorin duke e marrë parasysh pandeminë Covid-19, e këto sfida sigurisht e kanë prekur edhe funksionin e pajtueshmërisë brenda Bankës.

Banka jonë edhe gjatë këtij viti si dhe periudhës së pandemisë ka qenë e përkushtuar në respektimin e rregullatorëve dhe ligjeve në fuqi si dhe udhëzimeve të reja që BQK ka nxjerrë si pasojë e Covid-19.

Nga fillimi i pandemisë, Banka jonë ka aktivizuar ekipin e menaxhimit të pandemisë brenda bankës, ku pjesëmarrës ka qenë edhe departamenti i pajtueshmërisë së përgjithshme, si dhe ka ndjekur dhe ka zbatuar rekomandimet. Kjo me qëllim të ballafaqimit sa më efektiv me situatën e krijuar, ku janë koordinuar veprimet me të gjitha departamentet dhe funksionet brenda bankës, BQK-në dhe Shoqatën e Bankave si sektor bankar.

Departamenti i Pajtueshmërisë së Përgjithshme ka ndjekur të gjitha ndryshimet rregullative dhe udhëzimet e lëshuara gjatë vitit 2020 si dhe është analizuar ndikimi i tyre në Bankë. Palët relevante brenda Bankës janë informuar për këto ndryshime si dhe janë përfshirë në zbatimin e tyre.


Gjithashtu, departamenti i pajtueshmërisë së përgjithshme ka qenë pjesëmarrës në grupin për menaxhim të krizave të krijuar nga BQK lidhur me pandeminë, ku janë diskutuar efektet e udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe mënyrat për zbatimin e tyre.

Edhe pse shumicën e kohës që nga fillimi i pandemisë është punuar me staf të reduktuar, Banka ka zbatuar në mënyrë të plotë edhe sistemin e kontroleve të brendshme dhe ka pas në funksion mundësinë e raportimit të ndonjë shkelje eventuale që do të mund të ndodhte sidomos gjatë kësaj periudhe të ndjeshme të pandemisë.

Jemi kujdesur që gjatë gjithë kohës të rikujtojmë obligimet e dala nga Kodi i Mirësjelljes së Bankës secilit prej punonjësve të Bankës pa dallim pozite. Kjo ka qenë shumë e rëndësishme duke e ditur se pa marrë parasysh situatën pandemike ne si bankë kemi për obligim respektimin e rregullave dhe ligjeve dhe nuk duhet të lejojmë që kjo situatë të ndikoj në shpërqendrimin e punonjësve.

Banka Ekonomike si çdo herë tjetër edhe në vitin 2020 i ka kushtuar rëndësi të veçantë kujdesit ndaj klientëve dhe trajtimit të ankesave të tyre, e sidomos në këtë periudhë të pandemisë. Sigurisht periudha e moratoriumit të kredive si pasojë e pandemisë sipas udhëzimeve të BQK-së ka ngritur vëmendjen e klientëve që të interesohen lidhur me këtë proces. Për secilën ankesë dhe kërkesë të klientit, pa marrë parasysh punën me staf të reduktuar, Banka ka arritur që të komunikoj me secilin klientë dhe të trajtoj kërkesat e tyre në kohë.

Ky menaxhim lidhur me kujdesin ndaj klientit dhe trajtimin e ankesave së bashku me funksionet e tjera në Bankë lidhur me ristrukturimin e kredive si pasojë e Covid-19 në dy fazat gjatë vitit 2020 ka përfunduar pa krijuar paqartësi dhe panik tek klientët.



BANKA EKONOMIKE SH.A.

Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje
me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020
(së bashku me Raportin e Auditorit të Pavarur)

PËRMBAJTJA

Raporti i Auditorit të pavarur	76
Pasqyra e pozicionit financiar	78
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	79
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	80
Pasqyra e rrjedhës së parasë	82
Shënime për pasqyrat financiare.....	84-184

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Aksionarët e

Banka Ekonomike Sh.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka Ekonomike Sh.A. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

Bazat për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona nën këto standarde janë të sqaruara më tutje në seksionin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me kërkesat etike të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë dhe ne kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit të BSNEK-së. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

Siç është shpalosur në Shënimin 17 të pasqyrave financiare shoqëruese, më 31 dhjetor 2020 gjithsej kapitali aksionar i Bankës i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës është në vlerë prej 24,543,669.93 euro. Kapitali aksionar i Bankës i paraqitur në librat e saj dhe në pasqyrat financiare shoqëruese është në vlerë prej 29,422,189 euro dhe nuk barazohet me kapitalin aksionar të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Opinionin ynë nuk është modifikuar për sa i përket kësaj çështjeje.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuideojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyrat financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Banka mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të terheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Banka të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Banka Ekonomike Sh.A., përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Prishtinë,
19 prill 2021


Suzana Stavrik
Auditor ligjor



Pasqyra e pozicionit financiar

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	6	24,860	24,309
Balanca me Bankën Qendrore të Kosovës	7	57,530	41,844
Kredi për klientët	8	247,123	208,434
Investime në letra me vlerë	9	25,365	35,101
Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	10	8,768	9,925
Pasuri të paprekshme	11	2,813	565
Pasuri të tjera	12	1,423	2,187
Gjithsej pasuritë		367,882	322,365
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	13	330,281	282,683
Detyrime ndaj bankave	14	2,080	2,100
Borxh i varur	15	-	1,050
Detyrimi aktual tatimor		6	151
Detyrime të tjera	16	2,183	3,056
Detyrimi i shtyer tatimor	23	-	435
Gjithsej detyrimet		334,550	289,475
Ekuiteti dhe rezervat			
Kapitali aksionar	17	29,422	27,761
Rezerva e rivlerësimit	17	63	372
Fitime të mbajtura		3,847	4,757
Gjithsej ekuiteti dhe rezervat		33,332	32,890
Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat		367,882	322,365

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 7 deri në faqen 78, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi Drejtues i Bankës me 17.04.2021, dhe nënshkruar në emër të tyre nga:



Z. Shpend Luzha
Kryeshef Ekzekutiv



Z. Fitim Rexhepaj
Zyrtar Kryesor për Financa

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019
Të ardhurat nga interesi	18	18,130	16,020
Shpenzimet e interesit	18	(2,640)	(2,371)
Të ardhurat neto nga interesi		15,490	13,649
Të ardhurat nga tarifa dhe komisionet	19	2,748	2,928
Shpenzimet nga tarifa dhe komisionet	19	(825)	(905)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet		1,923	2,023
Të ardhurat e tjera operative	20	952	950
Humbja/fitimi neto nga këmbimi valutor		49	44
Të ardhurat		18,414	16,666
Shpenzimet e personelit	21	(3,466)	(3,275)
Zhvlerësimi pasurive, pajisjeve dhe ROU	10	(1,975)	(1,615)
Amortizimi i pasurive të paprekshme	11	(302)	(211)
Shpenzime të tjera	22	(5,059)	(4,300)
Humbjet neto nga zhvlerësimi për kreditë	8	(3,133)	(1,004)
Gjithsej shpenzimet operative		(13,935)	(10,405)
Fitimi para tatimit		4,479	6,261
Tatimi në fitim	23	(470)	(763)
Fitimi neto për vitin		4,009	5,498
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			
Zvogëlimi i provizioneve për HPK për letrat me vlerë të borxhit		-	-
Rivlerësimi i letrave me vlerë (shënimi 17)		(309)	222
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		3,700	5,720

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 7 deri në faqen 78.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e rivlerësimit	Provizionet për HPK	Fitimet e mbajtura	Gjithsej kapitali dhe rezervave
Më 1 janar 2019	24,543	102	48	3,977	28,670
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet					
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët	3,218	-	-	(3,218)	-
Dividenta e shpërndarë	-	-	-	(1,500)	(1,500)
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	3,218	-	-	(4,718)	(1,500)
Fitimi për vitin	-	-	-	5,498	5,498
<i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>					
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	222	-	-	222
Gjithsej i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	222	-	5,498	5,720
Më Dhjetor 2019	27,761	324	48	4,757	32,890
Më 1 janar 2020	27,761	324	48	4,757	32,890
Aplikimi fillestar i ndryshimit nga raportimi i BQK-së në SNRF sipas kërkesave të BQK-së (shenimi 17)	-	-	-	442	442
Bilanci më 1 janar 2020 me efektin e kalimit nga raportimi i BQK-së në SNRF (i rishfaqur)	27,761	324	48	5,199	33,332
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet					
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët	3,361	-	-	(3,361)	-
Dividenta e shpërndarë	-	-	-	(2,000)	(2,000)
Tërheqja e kapitalit aksionar	(1,700)	-	-	-	(1,700)

Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	1,661	-	-	(5,361)	3,700
Fitimi për vitin	-	-	-	4,009	4,009
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>					
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	(309)	-	-	(309)
Gjithsej i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(309)	-	4,009	3,700
Më Dhjetor 2020	29,422	15	48	3,847	33,332

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 7 deri në faqen 78, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënimi	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019
Aktivite operative			
Fitimi para tatimit		4,479	6,260
Ndryshime për:			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	10,11	2,277	1,826
Humbje neto nga dëmtimi i kredive për klientët	8	3,133	1,004
Ngarkesa / (lirimi) i provizionit për garancitë	20	(2)	(1)
Të ardhurat nga interesi	18	(18,130)	(16,020)
Shpenzimet e interesit	18	2,640	2,371
Humbje para ndryshimeve në pasuri dhe detyrimet operative		(5,604)	(4,560)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
Rezerva statutorë me BQK-në	6	(3,147)	(2,871)
Kredi për klientët	8	(40,619)	(39,185)
Pasuri të tjera	12	764	(697)
Detyrime ndaj klientëve	13	47,599	34,510
Detyrime ndaj bankave	14	(20)	9
Detyrime të tjera	16	(145)	3,583
		(1,172)	(9,211)
Interesi i paguar		(2,208)	(2,265)
Interesi i arkëtuar		16,681	15,871
Tatim mbi të ardhurat i paguar		(866)	(512)
Paraja neto e gjeneruar nga/(përdorur në) aktivitetet operative		12,435	3,828
Aktivite investuese			
Blerja e pronave, pajisjeve dhe pasuritë e paprekshme	10,11	(3,223)	(5,538)
Kthimet (blerjet) neto të letrave me vlerë		(27,039)	(33,907)
Zvogëlimi në letrat me vlerë		36,395	24,581
Paraja neto e gjeneruar / (përdorur) nga aktivitetet investuese		6,133	(14,864)

Aktivitetet financiare			
Shlyerja e borxhit		(1,050)	-
Shlyerja e detyrimit të qirasë		(727)	(865)
Dividentët e paguar		(2,000)	(1,500)
Tërheqja e kapitalit aksionar		(1,700)	-
Paratë e gatshme neto (të përdorura) në aktivitetin financiar		(5,477)	(2,365)
Rritja / (ulja) neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		13,091	(13,346)
Dega	Shuma e qirasë operative	Baza për tatim	Tatimi në qira	Shuma minimale e pagesës	Nënqiratë	Detyrimi kontigjent
Dega e Prishtinës	395	348	31	395	85	310
Dega e Gjakovës	47	41	4	47	2	45
Dega e Pejës	96	88	8	96	22	74
Dega e Prizrenit	41	42	4	41	14	27
Dega e Mitrovicës	53	53	5	53	2	51
Dega e Gjilanit	87	77	7	87	42	45
Dega e Ferizajit	68	66	6	68	18	50
Zyra Qendrore	83	71	6	83	47	36
Gjithsej	870	786	71	870	232	638

Çështjet gjyqësore

Më 31 dhjetor 2020, ka disa çështje gjyqësore të ngritura kundër Bankës. Banka ka njohur gjatë vitit 2020 provizione për humbjet e mundshme në shumën prej : 8 mijë euro (31 dhjetor 2018: 90 mijë euro, në lidhje me çështjet gjyqësore të hapura në datën e raportimit. Veprime ligjore të ndryshme dhe pretendime mund të lindin në të ardhmen kundër Bankës prej çështjeve gjyqësore që lidhen me rrjedhën normale të biznesit. Rreziqet e lidhura me to janë analizuar nga menaxhmenti për mundësitë e ndodhjes. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të saktësohet gjithmonë, menaxhmenti beson se nuk ka të ngjarë të rezultojnë detyrime të tjera material.

25. Transaksionet me palët e lidhura

Në përputhje me SNK 24 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura", një palë e lidhur është çdo palë që ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrijë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative.

Transaksionet me palët janë bërë në kushte të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksionet në treg. Në rrjedhën e kryerjes së aktiviteteve bankare, Banka hyn në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura dhe gjendet me aksionarët dhe individët apo shoqëritë e tjera të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	Bordi i Drejtorëve		Menaxhmenti kyç		Aksionarët kryesorë dhe palët e lidhura me ta		Gjithsej	
	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019
<i>Kredi dhënë klientëve</i>								
Kredi dhënë klientëve, bruto	-	-	82	187	6,396	3,496	6,478	3,683
Parapagimet – BV	-	-	-	-	2,147	1,156	2,147	1,156
Lejimet për zhvlerësim	-	-	(2)	(2)	(32)	(15)	(34)	(17)
Kredi dhënë klientëve, neto	-	-	80	185	8,511	4,637	8,591	4,822
Kolateral në mjete monetare	-	-	(223)	(519)	(18,862)	(12,487)	(19,085)	(13,006)
Ekspozimi neto	-	-	(143)	(334)	(10,351)	(7,850)	(10,494)	(8,184)
Garancitë	-	-	-	-	198	174	198	174
Kolateral në mjete monetare	-	-	-	-	(4,580)	(215)	(4,580)	(215)
Ekspozimi neto	-	-	-	-	(4,382)	(41)	(4,382)	(41)
Depozita të klientëve	16	16	79	98	19,916	12,570	20,010	12,683
Borxhi i varur	-	-	-	-	-	1,050	-	1,050

Vlera totale e vlerësuar e kolateralit duke llogaritur edhe garancionet, përfituar nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 ishte 23,710 mijë euro. Në 31 dhjetor 2019 vlera e tillë e vlerësuar ishte 19,762 mijë euro.

Angazhimet e papërdorura për kredi me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020, janë 358 mijë euro (2019: 629 mijë euro).

Depozitat e palëve të lidhura përbëjnë 6.02 % (2019: 4.5 %) të gjendjes totale të depozitave të klientëve.

Transaksionet me palët e lidhura gjatë 2020 dhe 2019 janë si në vijim:

	Bordi i Drejtorëve		Menaxhmenti kyç		Aksionarët kryesorë dhe palët e lidhura me ta		Gjithsej	
	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019
Të hyrat nga interesi	-	-	6	8	283	193	289	201
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	-	-	-	-	37	31	38	32
Shpenzimet e interesit	-	-	-	-	(20)	(230)	(20)	(230)
Shpenzimet e implementimit-BV	-	-	-	-	(354)	(356)	(354)	(356)

Shpërblimi gjithsej për menaxhmentin kyç të Bankës është si në vijim:

	2020	2019
Përfitimet afatshkurtra të punonjësve për Bordin Drejtues	77	71
Përfitimet afatshkurtra të punonjësve për menaxhmentin kyç	232	205
	309	276

27. Menaxhimi i rrezikut financiar

(a) Hyrje dhe përmbledhje

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiarë:

- Rreziku i tregut
- Rreziku kreditor
- Rreziku i likuiditetit

Struktura për menaxhimin e rrezikut

Ky shënim paraqet informacione rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit rrezik më sipër, objektivave, politikave dhe proceseve të saj për matjen dhe menaxhimin e rrezikut si dhe menaxhimin e kapitalit të saj.

Bordi i Drejtorëve ("Bordi") ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka themeluar Komitetin e Pasurive dhe Detyrimeve ("ALCO"), Komitetin e Likuiditetit, Komitetin e Kredive, Komitetin e Auditimit, dhe Komitetin e Manaxhimit të Rrezikut, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të Bankës mbi menaxhimin e rrezikut në fushat e tyre specifike. Të gjitha Komitetet e Bordit të Drejtorëve kanë anëtar ekzekutiv dhe jo ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Banka, për të përcaktuar limitet dhe kontrollet e rrezikut, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat e saj të menaxhimit të rrezikut dhe sistemet rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në tregje, produkte dhe shërbime të ofruara.

Banka synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit të kuptojnë rolin dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat për menaxhimin e rrezikut të Bankës dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e kuadrit për me-

naxhimin e rrezikut në raport me rreziqet me te cilat përballet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës në këto funksione ndihmohet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i Brendshëm kryen rishikime në mënyrë të rregullta dhe spontane të kontrollit dhe procedurave për menaxhim e rrezikut, rezultati i te cilave raportohet tek Komiteti i Auditimit.

Banka operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike në zhvillim e sipër. Zgjerimi i saj i mëtejshëm mund të rezultojë në ndikime negative në pozicionin financiar të Bankës. Menaxhmenti i Bankës monitoron çdo ditë pozicionin e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe merr masat e përshtatshme në lidhje me rrezikun e kredisë, të tregut (normës primare të interesit) dhe likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet negative të mundshme nga kriza financiare dhe ekonomike globale. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet sfidave të tregut, duke mbajtur një pozicion të mjaftueshëm likuid dhe të kapitalit.

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare të Bankës nëse një klient ose kundërparti e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe lidhet kryesisht me kredi dhe paradhënie ndaj klientëve dhe bankave të tjera. Për qëllime të raportimit financiar Banka merr në konsideratë dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (rreziku i mospagës të huamarrësit individual, rreziku i vendit dhe rreziku i sektorit).

Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Bordi i Drejtorëve i ka deleguar Komitetit të Kredisë përgjegjësinë për monitorimin e rrezikut të kredisë. Një departament të veçantë i Rrezikut të kredisë është përgjegjës për administrimin e rrezikut të kredisë të Bankës. Menaxhimi i ekspozimit të rrezikut të kredisë për huamarrësit nga Komiteti i Rrezikut kryhet nëpërmjet analizave të rregullta të besueshmërisë se huamarrësit. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë gjithashtu menaxhohet pjesërisht duke përfituar kolateral dhe garanci.

27. Manaxhimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë

Tabelat më poshtë paraqesin informacione mbi cilësinë kreditore të asetet financiare dhe zbritjet për zhvlerësime/humbje krijuar nga Banka kundrejt këtyre pasurive. Tabela më poshtë paraqet rastin më të keq të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë për Bankën më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, pa marrë në konsideratë ndonjë kolateral të mbajtur ose mbrojtje të tjera ndaj rrezikut të kredisë. Për pasuritë financiare, ekspozimet e mëposhtme paraqesin vlerën e mbartur ashtu siç është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

	Kredi dhe paradhënia për klientët		Investime në letra me vlerë		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare	
	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019
<i>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë</i>								
Vlera e bartur	247,123	208,434	25,365	35,101	70,263	56,007	-	-
	247,123	208,434	25,365	35,101	70,263	56,007	-	-
<i>Me kosto të amortizuar</i>	257,133	215,714	25,365	35,101	70,263	56,007	-	-
Lejimet për zhvlerësim	(10,010)	(7,280)	-	-	-	-	-	-
Vlera kontabël neto	247,123	208,434	25,365	35,101	70,263	56,007	-	-
							-	-
<i>Jashtë bilancit: ekspozimi maksimal</i>							-	
<i>Garanci financiare: rrezik i ulët/i pranueshëm</i>	15,567	15,811	-	-	-	-	2,294	2,154
<i>Angazhime/garanci Gjithsej</i>	15,567	15,811	-	-	-	-	2,294	2,154
<i>Provizionet e njohura si detyrim</i>	-	-	-	-	-	-	(12)	(13)
<i>Ekspozimi Gjithsej</i>	15,567	15,811	-	-	-	-	2,281	2,141

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)**

	2020				2019			
Kredi dhe paradhënie klientëve	Individë	Mikro	Korporata	Gjithsej kreditë	Individë	Mikro	Korporata	Gjithsej kreditë
Gjithsejt shuma bruto	93,536	68,499	95,098	257,133	80,117	55,291	80,306	215,714
Lejimet për zhvlerësim	(4,479)	(3,630)	(1,901)	(10,010)	(3,310)	(2,838)	(1,132)	(7,280)
Vlera kontabël neto	89,057	64,869	93,197	247,123	76,807	52,453	79,174	208,434
Me kosto të amortizuar								
Standarde	91,057	64,751	91,231	247,039	77,465	50,811	75,763	204,039
Në vëzhgim	355	494	1,938	2,787	1,363	1,794	2,344	5,501
Sub-standarde	441	335	195	972	190	382	618	1,190
Të dyshimta	536	942	131	1,608	352	674	302	1,328
Humbje	1,147	1,977	1,603	4,727	747	1,630	1,279	3,656
Gjithsejt bruto	93,536	68,499	95,098	257,133	80,117	55,291	80,306	215,714
Gjithsej lejimet për provizione	(4,479)	(3,630)	(1,901)	(10,010)	(3,310)	(2,838)	(1,132)	(7,280)
Kreditë me kushte të rinegociuara								
Vlera kontabël	402	1,217	2,237	3,856	299	1,296	2,256	3,851
Lejimet për provizionim	(173)	(975)	(420)	(1,568)	(96)	(863)	(490)	(1,449)
Vlera kontabël neto	229	241	1,817	2,288	203	433	1,766	2,402
Kreditë në vonesë								
Jo në vonesë	88,855	60,697	88,392	237,944	75,715	48,276	72,559	196,550
Në vonesë 1-30 ditë	2,850	4,626	4,438	11,915	2,115	3,404	5,080	10,599
Në vonesë 31 - 90 ditë	424	627	619	1,670	1,434	1,762	1,131	4,327
Në vonesë 91 – 365 ditë	604	744	141	1,489	382	672	768	1,822
Në vonesë mbi 365 ditë	802	1,805	1,508	4,115	471	1,177	768	2,416
	93,536	68,499	95,098	257,133	80,117	55,291	80,306	215,714

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Zhvlerësime dhe provizionime

Provizionet Gjithseje që kërkohen nga Rregullorja e BQK për “Menaxhimin e Rrezikut Kreditor të Bankave” (shih 3.(f)(vii)) përfshijnë humbje të ndodhura/pësuara në datën e raportimit dhe humbjet e pritshme.

Banka vlerëson probabilitetin e dështimit në pagim të kundërpalëve, duke përdorur mjete të brendshme rangimi/renditje të përshtatshme për kategori të ndryshme kundërpalesh. Mjete të tilla kombinojnë analizën dhe gjykimin dhe janë të vlefshme, kur është e përshtatshme, duke u krahasuar me të dhëna të jashtme të disponueshme.

Kundërpalët janë segmentuar në pesë kategori dhe klasifikimi i Bankës, i cili është treguar më poshtë, reflekton intervalin e probabilitetit të dështimit, të përcaktuar për çdo kategori. Ekspozimet lëvizin midis kategorive kur vlerësimi i probabilitetit të dështimit ndryshon. Mjetet e rankimit rishikohen në mënyrë të vazhdueshme, përmirësohen dhe validohen nga Banka.

Kreditë janë ranguar nga A në E në sistemin e brendshëm të rangimit të rrezikut të kredisë:

- A Standarde
- B Vrojtuese
- C Nënstandarde
- D Të dyshimta
- E Të humbura

Banka raporton klasifikimin e humarrësve të saj, tek BQK dhe Regjistri i Kredisë së Kosovës. Politika e provizionimit për këto kredi është detajuar në shënimin 3.(f) (vii).

Vlerësimet individuale dhe kolektive të portofolit të kredisë

Për qëllime të manaxhimit të brendshëm, Banka veçon kreditë në kredi që vlerësohen individualisht për zhvlerësim: këto janë kredi të klasifikuara si nënstandarte ose më ulët. Të gjitha kreditë e tjera analizohen kolektivisht/në grup për qëllime të vlerësimit për zhvlerësim.

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Banka vlerëson HPK (humbjet e pritshme të kredisë) mbi baza individuale për ekspozimet e papaguara më të mëdha se 100 mijë EUR që klasifikohen në fazën 3 në bazë mujore, ndërsa me NEI diskonton fluksin e parashikuar të parave. Për më tepër, ekspozime të tilla monitorohen nga afër nga Banka dhe raportohen për shkak të madhësisë së tyre dhe ndikimit të mundshëm në fitimin ose humbjen e Bankës. (2020: 100 mijë euro të paktën një herë në muaj kur rrethanat individuale e kërkojnë atë).

Kreditë në vonesë por të pazhvlerësuara

Kreditë dhe letrat me vlerë, ku interesat kontraktuale ose pagesat e principalit janë të skaduara, por Banka beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit të disponueshëm dhe/apo në stadin e mbledhjes së shumave që i detyrohen Bankës.

Kredi me kushte të rinegociuara

Kredi me kushte të rinegociuara/ndryshuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe ku Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do ti bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar ajo mbetet në këtë kategori, pavarësisht performancës së kënaqshme pas ristrukturimit.

Politika e fshirjes

Banka fshin një kredi (dhe çdo zbritje për zhvlerësim të lidhur me të) me vendimin e Bordit Drejtues, në përputhje me rregullorën e Bankës Qendrore të Kosovës. Vendimi i fshirjes merret pas marrjes në konsideratë të informacioneve të tilla si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në situatën financiare të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajnë më detyrimin ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin Gjithsej. Shuma Gjithseje e fshirë gjatë vitit 2020, ishte 392 mijë EUR (2019: 1,594 mijë EUR).

Depozita nga bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare me bankat lokale të shëndetshme apo me bankat ndërkombëtare. Para se një marrëdhënie biznesi të nisë me një bankë të caktuar, Departamenti i Rrezikut dhe i menaxhmenti kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të tjera monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime të investimeve, moni-

torohen vazhdimisht për renditjen e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor's (S & P), Fitch dhe Moody's. Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ekspozim Gjithsej të rrezikut të kredisë ndaj palëve të lidhura që tejkalon 15% të kapitalit rregullator të klasit të parë. Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave janë dhënë pa kolateral. Tabela më poshtë paraqet llogaritë rrjedhëse të bankave dhe depozitat me afat me bankat korrespondente sipas rankimit kreditor:

Më 31 dhjetor	2020	2019
AAA+ to BBB-	8,316	6,143
A+ to A-	168	183
BB+ to B-	118	-
BBB+ to B-	701	613
Të pa ranguara	435	376
Bankat vendore	2,995	6,848
	12,733	14,163

Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë janë vetëm me Qeverinë e Kosovës. Këto letra me vlerë nuk janë të rankuara. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë paraqitet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Angazhimet për kredi dhe garancitë financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka duhet të paguajë nëse garancia kërkohet, e cila mund të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e madhe se shuma e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për angazhimet e kreditimit është shuma e plotë e angazhimit.

27. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kontrolli i limitit të rrezikut dhe politikat e zbutjes

Banka menaxhon kufijtë dhe kontrollon përqendrimet e rrezikut të kredisë, kudo që këto janë identifikuar, në mënyrë të veçantë me palë individuale, me grupet dhe me degët.

Banka strukturon nivelet e rrezikut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në shumën e pranuar në lidhje me një huamarrës, ose grup huamarrës, dhe për segmentet gjeografike dhe industriale. Rreziqe të tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor, ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditimit manaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve të mundshëm për të përmbushur shlyerjen e detyrimeve të interesit dhe të principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme. Kontrollat e tjera dhe masat reductive janë përshkruar më poshtë.

Kolaterali i mbajtur dhe përmirësime kreditore të tjera dhe efekti i tyre financiar

Banka mban kolateral kundrejt kredive dhe paradhëniesve ndaj klientëve në formën e interesave hipotekore mbi prona dhe pengje mbi aktive të luajtshme. Vlerësimi i vlerës së drejtë bazohet në vlerën e kolateralit të vlerësuar në momentin e huadhënies. Zakonisht nuk mbahet kolateral për kredi dhe paradhënie ndaj bankave. Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe mbrojtjeve të tjera kundrejt kredive paraqitet më poshtë:

	2020		2018	
	Kredi dhe paradhënie klientëve	Vlera e drejtë e kolateralit	Kredi dhe paradhënie klientëve	Vlera e drejtë e kolateralit
Hipoteka	71,941	69,023	57,982	54,467
Kolateral në mjete monetare	7,316	7,316	2,402	2,401
Pengje	112,486	80,099	98,134	72,757
Miks (hipoteke dhe peng)	57,958	55,971	50,731	48,868
Pa kolateral	7,432	-	6,465	-
Gjithsej	257,133	212,410	215,714	178,493

Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Më 31 dhjetor 2020, Banka ka pasur ekspozim që tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të parë. Ekspozimi më i lartë ishte në: 13.13% (2019: Banka nuk ka pasur asnjë ekspozim që tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të parë. Ekspozimi më i lartë ishte në 10.19%). Ekspozimi ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020, përfaqëson 23.38% (2019: 14.38%) të kapitalit të nivelit të parë. Pjesa më e madhe e ekspozimit me palët e lidhura mbulohet me kolateral në mjete monetare që përfaqëson 8.76% (2019: 7.71%) të kapitalit të nivelit të parë.

Banka monitoron përqendrimin e rrezikut të kredisë sipas sektorëve dhe vendndodhjeve gjeografike. Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kredisë në datën e raportimit është paraqitur *më poshtë*:

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Përqendrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)

	Kredi dhe paradhënia për klientët		Investime në letra me vlerë		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare	
	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019
Përqendrimi sipas sektorëve								
Korporata	93,197	79,174	-	-	-	-	1,484	1,499
Qeveria	-	-	25,365	35,101	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	70,263	56,007	-	-
Individët	89,057	76,807	-	-	-	-	-	-
Mikro bizneset	64,869	52,453	-	-	-	-	810	655
Gjithsej	247,123	208,434	25,365	35,101	70,263	56,007	2,294	2,154
Përqendrimi sipas vendndodhjes								
Vendet e BE	-	-	-	-	9,638	6,318	-	-
Republika e Kosovës	247,123	208,434	25,365	35,101	60,625	49,689	2,294	2,154
Gjithsej	247,123	208,434	25,365	35,101	70,263	56,007	2,294	2,154

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e këmbimit valutor dhe shpërndarjet e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në situatën kreditore të emetuesit / huamarrësti), do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e investimeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i menaxhimi të rrezikut të tregut është që të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që flukset monetare të ardhshme do të luhaten nga ndryshimet e normës së interesit të tregut dhe rreziku që maturiteti i aktiveve interesprurëse ndryshon nga maturiteti i detyrimeve interesmbartëse të përdorura për të financuar këto aktive. Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar, tregon se deri në çfarë mase është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivitet dhe depozitat e konsumatorëve kanë norma fikse interesi.

Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivitet dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohe të ndryshme ose shuma të ndryshme. Banka përpiqet të zvogëlojë këtë rrezik duke monitoruar datat e rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Përveç kësaj, efekti aktual do të varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën pagesat janë bërë me herët ose më vonë se data e kontraktuar dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të rivlerësimit dhe ndërmjet monedhave.

Ekspozimet e Bankës janë të bazuara normat e interesit të shënuara të Kosovës dhe Banka ballafaqohet vetëm me rrezik të rivënjes së çmimit.

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i normave të interesit (vazhdim)

Në baza tremujore mbahen takime të Menaxhimit të rrezikut operacional, ku diskutohen çështjet e mëposhtme:

- Raporti mbi Rrezikun Operacional që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e Likuiditetit dhe të Tregut që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e normës së interesit - Raporti përgatitet nga Departamenti i Rrezikut. Raporti detajon normat e interesit të Bankës në krahasim me normat e interesit të tregut dhe jep detaje të ndryshimeve në normat e interesit në treg, çdo luhatje të pazakontë etj.

Departamenti i Rrezikut në një bazë të vazhdueshme monitoron rrezikun e normave të interesit përmes monitorimit të kushteve të tregut dhe duke marrë vendime të nevojshme të ri-çmimit ose rialokimit me miratimin e Komitetit të Pasurive dhe Detyrimeve. Një raport në lidhje me këtë monitorim është përgatitur

dhe paraqitur në mbledhjen e Komiteti të Pasurive dhe Detyrimeve. Masat e nevojshme merren nëse normat e interesit ndryshojnë negativisht. Raporti përfshin analizë mbi depozituesit e mëdhenjë, ndikimin e tyre në normat e depozitave, investimet dhe analizën e letrave me vlerë, normat mesatare të interesit në llogaritë e klientëve, analiza të rrezikut të likuiditetit, etj.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit

Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet që fitojnë interes dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e aktiveve dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme, Banka është e ekspozuar edhe ndaj rrezikut bazë, që është diferenca në karakteristikat e ricimit të indekseve të ndryshme të normave luhatëse, të tilla si norma e kursimit, LIBOR dhe lloje të ndryshme të interesit. Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut në përputhje me strategjitë e biznesit të Bankës.

Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut të aktiveve dhe detyrimeve janë kryer në kontekst të ndjeshmërisë së Bankës ndaj ndryshimeve në normat e interesit. Në mjediset e rënies së normave të interesit, marzhi i fitimit do të ngushtohet, derisa normat e interesit në detyrime do të ulen me një përqindje më të ulët në krahasim me normat e interesit të aktiveve. Megjithatë, efekti aktual do të varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe stabilitetin e ekonomisë, mjedisit dhe nivelin e inflacionit.

Normat e kthimit mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si në vijim:

	USD		EUR		CHF	
	2020	2019	2020	2019	2020	2019
Asetet						
Paraja e gatshme dhe në banka	0.88	1.17	(0.2)	(0.2)	(1.55)	(1.78)
Gjendja me BQK	-	-	(0.6)	(0.6)	-	-
Kredi klientëve	-	-	7.1	7.41	-	-
Investime financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	3.3	3.21	-	-
Investime në letra me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	1.3	0.03	-	-
Detyrimet						
Depozita të klientëve	-	0.28	0.8	0.86	-	-
Borxhi i varur	-	-	7.5	7.5	-	-

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limiteve të hendekut të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimve financiare të Bankës ndaj disa skenareve standarde dhe jo-standarde të normave të interesit. Skenarët standardë përfshijnë një rënie dhe rritje paralele 1 % në lakoren e kthimit.

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në tregun e normave të interesit (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike në lakoren e pëqindjeve dhe një pozitë financiare të qëndrueshme) është si vijon:

Efekti i vlerësuar i fitimit (humbjes)	Skenari deri në 1 vit		Skenari mbi 1 vit	
	100 bp	100 bp	100 bp	100 bp
	Rritje	Ulje	Rritje	Ulje
2020	(70)	40	207	(216)
2019	(46)	28	190	(200)

Tabela në vijim tregon instrumentet financiare që sjellin dhe që nuk sjellin interes sipas datës së maturimit. Rritja / rënia nuk është simetrike, sepse asetet e kursimit kanë normat 0.25% dhe në rast të rritjes për 100pb ato arrijnë 1.25%, ndërsa në rast rënieje për 100bp, ato arrijnë deri në 0%. E njëjta gjë është me vendosjet; norma e tyre është 0% dhe në rast të rritjes me 100bp arrijnë në 1.00%, dhe në rast rënie ato arrijnë në 0%. Këto asete janë afatshkurtra, prandaj ato kanë prekur vetëm pjesën deri në një vit. Nuk ka asete afatgjata, kështu që ato nuk ndikojnë në pjesën mbi një vit.

31 Dhjetor 2020	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartëse	Gjithsej
Asetet								
Paraja e gatshme dhe në banka	-	-	-	-	-	-	24,860	24,860
Gjendja me BQK	57,530	-	-	-	-	-	-	57,530
Investimet në letra me vlerë	-	1,519	-	553	23,294	-	-	25,365
Kredi klientëve – Norma fikse	5,150	6,296	11,017	24,132	118,232	82,296	-	247,123
Asetet tjera	-	-	-	-	-	-	916	916
Gjithsej	62,679	7,815	11,017	24,685	141,526	82,296	25,776	355,795
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	191,406	8,082	9,222	60,291	60,642	639	-	330,281
Detyrimet ndaj bankave	2,080	-	-	-	-	-	-	2,080
Borxh i varur - norma fikse	-	-	-	-	-	-	-	-
Detyrimet tjera	-	-	-	-	-	-	2,094	2,094
Gjithsej	193,486	8,082	9,222	60,291	60,642	639	2,094	334,455
Hendeku	(130,807)	(267)	1,795	(35,606)	80,884	81,657	23,683	21,340
Hendeku kumulativ	(130,807)	(131,074)	(129,278)	(164,884)	(84,000)	(2,343)	21,340	-

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i tregut (vazhdim)****Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)**

31 Dhjetor 2019	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartëse	Gjithsej
Asetet								
Paraja e gatshme dhe në banka	-	-	-	-	-	-	24,309	24,309
Gjendja me BQK	41,844	-	-	-	-	-	-	41,844
Investimet në letra me vlerë	-	5,016	2,004	11,052	17,029	-	-	35,101
Kredi klientëve – Norma fikse	1,861	6,284	10,522	19,072	117,450	53,245	-	208,434
Asetet tjera	-	-	-	-	-	-	685	685
Gjithsej	43,705	11,300	12,526	30,124	134,479	53,245	24,994	310,373
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	152,012	11,256	6,716	32,153	80,408	138	-	282,683
Detyrimet ndaj bankave	2,100	-	-	-	-	-	-	2,100
Borxh i varur - norma fikse	-	-	1,050	-	-	-	-	1,050
Detyrimet tjera	-	-	-	-	-	-	2,978	2,978
Gjithsej	154,112	11,256	7,766	32,153	80,408	138	2,978	288,811
Hendeku	(110,407)	44	4,760	(2,029)	54,071	53,107	22,016	21,562
Hendeku kumulativ	(110,407)	(110,363)	(105,603)	(107,632)	(53,561)	(453)	21,562	-

Rreziku i monedhës

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës nëpërmjet transaksioneve në monedhë të huaj. Banka sigurohet se ekspozimi neto mbahet në nivele të pranueshme duke shitur dhe blerë monedha të huaja me

kursin “spot” kur është e nevojshme që të rregullohen balancat afatshkurtra. Rreziku i monedhës së huaj nuk është i rëndësishëm, meqë pjesa më e madhe e transaksionve të Bankës janë në monedhën vendase. Monedhat e huaja me të cilat Banka operon janë Dollari Amerikan (USD), Franga Zvicerane (CHF) dhe GBP. Normat e përdorura për këmbim më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si në vijim:

	2020	2019
Monedha	EUR	EUR
1 USD	1.2271	1.1234
1 CHF	1.0802	1.0854
1 GBP	0.8990	0.8508

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në kursin e këmbimit është si në vijim:

	USD		CHF		GBP	
	2020	2019	2020	2019	2020	2019
Ndjeshmëria ndaj kursit	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Fitim ose Humbje						
+5% e Euros	0.93	0.35	14.16	0.13	0.11	0.12
- 5% e Euros	(0.93)	(0.35)	(14.16)	(0.13)	(0.11)	(0.12)

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave të huaj, i shprehur në ekuivalentë të Euro-s është si në vijim:

31 dhjetor 2020	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Asetet					
Paraja e gatshme dhe në banka	16,368	3,182	4,869	441	24,860
Gjendja me BQK	57,530	-	-	-	57,530
Investimet në letra me vlerë	25,365	-	-	-	25,365
Kredi klientëve	247,123	-	-	-	247,123
Asetet tjera	916	-	-	-	916
	347,302	3,182	4,869	441	355,795
Detyrimet					
Detyrime ndaj klientëve	322,092	3,164	4,586	439	330,281

Detyrime ndaj bankës	2,080	-	-	-	2,080
Borxhi i varur	-	-	-	-	0
Detyrime tjera	2,094	-	-	-	2,094
	326,266	3,164	4,586	439	334,455
Pozicioni neto në valutë të huaj	21,036	19	283	2	21,340
31 dhjetor 2019	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Asetet					
Paraja e gatshme dhe në banka	16,895	2,030	5,046	338	24,309
Gjendja me BQK	41,844	-	-	-	41,844
Investimet në letra me vlerë	35,101	-	-	-	35,101
Kredi klientëve	208,434	-	-	-	208,434
Asetet tjera	685	-	-	-	685
	302,959	2,030	5,046	338	310,373
Detyrimet					
Detyrime ndaj klientëve	275,281	2,023	5,043	336	282,683
Detyrime ndaj bankës	2,100	-	0.40	-	2,100
Borxhi i varur	1,050	-	-	-	1,050
Detyrime tjera	2,978	-	-	-	2,978
	281,409	2,023	5,043	336	288,811
Pozicioni neto në valutë të huaj	21,550	7	3	2	21,562

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është se Banka do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve nga detyrimet financiare të saj.

Qasja e Bankës për administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, sa më shumë që është e mundur, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kohë, në kushte normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të papranueshme apo pa rrezikuar të dëmtojë reputacionin e Bankës. Banka monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur janë të pagueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Fondet mbliidhen duke përdorur një segment instrumentesh që përfshijnë depozita të klientëve, borxhe të varura dhe kapital aksionar.

Banka ka një rezervë likuiditeti në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës që është llogaritur në bazë të nevojave të likuiditetit të Bankës dhe që është në dispozicion në rastet e problemeve të likuiditetit. Shuma e rezervës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 arritën në 22,720 mijë euro (me 31 dhjetor 2019: 19,573 mijë euro).

Më tej, Banka, ka marrë borxh të varur në shumë prej 1,000 mijë euro për të mbuluar ndonjë rast të mangësive të likuiditetit. Borxhi i varur ka maturuar dhe është mbyllur më 30.04.2020 sipas marrëveshjes.

Një burim tjetër për të mbuluar boshllëqet e likuiditetit është kapitali aksionar i Bankës që arrin në 29,422 mijë euro me 31 dhjetor 2020 (me 31 dhjetor 2019: 27,761 mijë euro).

Fleksibiliteti kufizon varësinë ndaj secilit prej burimeve të financimit dhe zakonisht ul koston e financimit. Banka përpiqet të ruaj një ekuilibër midis financimit të vazhdueshëm dhe fleksibiliteti nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të ndryshme. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshime në financime të nevojshme, të kërkuara për të arritur qëllimet e biznesit në terma të strategjisë së përgjithshme të Bankës. Për më tepër Banka mban një portfol të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Maturiteti kontraktual i mbetur i pasurive dhe detyrimeve financiare

Tabela e mëposhtme tregon flukset monetare të skontuara të detyrimeve financiare të Bankës në bazë të maturitetit kontraktual më të hershëm të mundshëm. Banka pret që flukset monetare të këtyre instrumenteve të ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme nga analiza. Për shembull, depozitat në të parë pritet të kenë një gjendje të qëndrueshme ose një rritje të gjendjes.

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim) (d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2020	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	24,860	-	-	-	-	-	24,860
Gjendja me BQK	57,530	-	-	-	-	-	57,530
Investimet në letra me vlerë	-	1,519	-	553	23,294	-	25,365
Kredi klientëve	5,150	6,296	11,017	24,132	118,232	82,296	247,123
Pasuri të tjera	916	-	-	-	-	-	916
Total	88,456	7,815	11,017	24,685	141,526	82,296	355,795
Detyrimet							
Depozita të klientëve	191,406	8,082	9,222	60,291	60,642	639	330,281
Depozita të bankave	2,080						2,080
Borxhi i varur	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	135	1	17	15	888	1,037	2,094
Totali	193,621	8,082	9,239	60,306	61,530	1,676	334,455
Hendeku	(105,165)	(268)	1,778	(35,621)	79,996	80,620	21,340
Hendeku kumulativ	(105,165)	(105,433)	(103,655)	(139,276)	(59,280)	21,340	

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim) (d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2019	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Gjithseji
Asetet							
Paraja e gatshme dhe në banka	24,309	-	-	-	-	-	24,309
Gjendja me BQK	41,844	-	-	-	-	-	41,844
Investimet në letra me vlerë	-	5,016	2,004	11,052	17,029	-	35,101

Kredi klientëve	1,861	6,284	10,522	19,072	117,450	53,245	208,434
Asete tjera	685	-	-	-	-	-	685
Gjithsej	68,699	11,300	12,526	30,124	134,479	53,245	310,373
Detyrimet							
Detyrimet ndaj klientëve	152,012	11,256	6,716	32,153	80,408	138	282,683
Detyrimet ndaj bankave	2,100						2,100
Borxhi i varur	-	-	1,050	-	-	-	1,050
Detyrime të tjera	372	150	223	217	2,016	-	2,978
Gjithsej	154,484	11,406	7,989	32,370	82,424	138	288,811
Hendeku likuidues	(85,785)	(106)	4,537	(2,246)	52,055	53,107	21,562
Hendeku kumulativ	(85,785)	(85,891)	(81,354)	(83,600)	(31,545)	21,562	-

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Banka e menaxhon kapitalin e vet për të siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vijueshmërisë ndërsa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes optimizimit të raportit të borxhit dhe kapitalit. Struktura e kapitalit të Bankës përbëhet përfshin kapitalin aksionar, rezervat dhe fitimin e pashpërndarë.

Kapitali rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur masa të tjera, rregullat dhe normat e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik, zërave jashtë bilancit dhe rreziqeve të tjerë, i shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar i Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 8% për Kapitalin e Klasit të Parë dhe 12% për Gjithsejin e fondeve të veta.

Asetet e peshuara me rrezikun

Pasuritë peshohen sipas kategorive të gjera të rrezikut kombëtar, duke iu caktuar një peshë rreziku në përputhje me shumën e vlerësuar të kapitalit që konsiderohet të jetë e nevojshme për t'i mbështetur ato. Zbatohen gjashtë kategori të peshimit të rrezikut: (0%, 20%, 50%, 75%, 100%, dhe 150%): për shembull instrumentet e tregut të parasë peshohen me rrezik 0%, i cili nënkupton që nuk nevojitet kapital për të mbështetur mbajtjen e këtyre pasurive. Pasuritë afatgjata materiale peshohen me rrezik 100% çka nënkupton që ato duhet të mbështeten nga Kapital i Klasit të Parë në shkallën 8% të vlerës kontabël. Angazhimet

jashtë bilancit të lidhura me kreditimin merren në konsideratë. Shumat më pas peshohen me rrezikun duke përdorur përqindje të njëjtë me atë të pasurive të bilancit.

	2020	2019
Pasuritë gjithsej të peshuara me rrezik	219,890	216,022
Pasuritë gjithsej të peshuara me rrezik për rrezikun operacional	19,788	18,668
Gjithsej	239,678	234,690
Kapitali rregullator (gjithsej i kapitalit)	31,219	33,789
Raporti i adekuatshmërisë së kaptialit (Gjithsej i kapitalit)	13.03%	14.40%

Nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në menaxhimin e kapitalit të Bankës gjatë periudhës
Leva financiare

Komiteti i manaxhimit të rrezikut të Bankës rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, komiteti merr në konsideratë koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me çdo klasë të kapitalit. Bazuar në rregulloren e BQK raporti minimal i levës është 3%.

Norma e levës financiare në fund të vitit ishte si në vijim:

	2020	2019
Gjithsej Asetet	367,882	322,365
Ekuiteti	33,332	32,890
Raporti i levës	9.06%	10.20%

28. Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim ose shpallje në pasqyrat financiare.

